



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 13.11.2019, ora 10.00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj– Kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Prezantim, nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, në Komisionin për Ekonominë dhe Financat i projektligjit “Për Buxhetin e vitit 2019”.

- Paraqitja e raportit të Komisionit, në parim, për projektligjin “Për buxhetin e vitit 2019”

2. Prezantim, nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, në Komisionin për Ekonominë dhe Financat i projektligjeve të paketës fiskale .

- Paraqitja e raportit të relatorit të Komisionit, në parim, për projektligjet e paketës fiskale.

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Arben Elezi, Anastas Angjeli, Blerina Gjylameti, Evis Kushi, Xhavit Bushaj, Antoneta Dhima, Roland Xhelili, Senida Mesi, Vullnet Sinaj, Edlira Hyseni, Suzana Topi, Reme Lala, Artur Roshi, Krenar Rryçi, Korab Lita dhe Ylli Shehu, Eljo Hysko

Mungojnë:

Ervin Bushati,

Të ftuar:

Ministrja Znj. Anila Denaj,

Zv/Minister Z. Elton Haxhi,

Dejtoresha e pergjithshme e buxhetit, Znj. Mimoza Dhembli,

Drejtori i Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale, Z. Endrit Lami,

Drejtori i Përgjithshëm Politikave të Makroekonomisë, Çështjeve Fiskale dhe Punësimit, Z. Nikolla Lera.

Flogert Picalla
Violeta Shqalsi

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Mirëmëngjesi, të gjithëve!

Sot kemi hapjen e diskutimeve për projektbuxhetin e vitit 2020, i cili duhet të mbyllet në parim deri në datën 5. Është bërë e ditur në detaje e gjithë axhenda, ku do të fokusohet në parim, pastaj në detaje të ardhurat, shpenzimet, borxhin dhe koncesionet.

Kemi thirrur për të ardhur në komision Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë për të mbajtur qëndrimin e tij, siç është edhe tradita.

Relator për projektligjin “Për projektbuxhetin e vitit 2020” është Arben Ahmetaj.

Për sa i përket paketës fiskale është zoti Anastas Angjeli.

Të ftuar për prezantimin e projektligjit kemi: ministren e Ekonomisë dhe Financave, zonjën Anila Denaj, drejtoreshën e Përgjithshme të Buxhetit, zonjën Mimoza Dhembli, drejtorin e Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale, zotin Endrit Lami dhe drejtorin e Përgjithshëm të Politikave të Makroekonomisë Çështjeve Fiskale dhe Punësimit, zotin Nikolla Lera.

Para se t’i jap fjalën zonjës ministre, i uroj ditëlindjen zonjës Edlira Hyseni: edhe qindra!

Faleminderit për prezencën sot në ditën tuaj të veçantë!

Zonja Ministre, fjala për ju.

Anila Denaj - I nderuar zoti kryetar i komisionit,

Të nderuar deputetë,

Në këtë prezantim të buxhetit për vitin e ardhshëm 2020, më lejoni të jap disa informacione të përgjithshme mbi të cilat jemi bazuar për projeksionet, sikurse edhe për të gjithë pjesën e shpenzimeve.

Projektbuxheti i vitit 2020 dhe projektbuxheti afatmesëm në përgjithësi vijnë në mbështetje të vazhdueshme të reformave të qeverisë shqiptare për rritje cilësore dhe të qëndrueshme të ekonomisë, të punësimit, të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe avancim në procesin e aderimit në familjen europiane.

Përmes projektbuxhetit 2020, Ministria e Financave dhe Ekonomisë mbetet e angazhuar drejt një kuadri makroekonomik të kujdesshëm dhe realist, për një konsolidim

fiskal të vazhduar, financa publike të forta, stabilitet financiar dhe qëndrueshmëri të pozicionit të jashtëm të Shqipërisë.

Në terma të politikave dhe indikatorëve makroekonomikë, ky projektbuxhet synon:

Realizimin e një rritjeje ekonomike, e cila parashikohet të jetë në nivelin 4,1% në vitin 2020, një rritje e gjeneruar kryesisht nga kërkesa e brendshme, si konsumi ashtu edhe investimet. Kjo rritje e parashikuar për 2020-en do të përkthehet në më shumë punësim: krijimin e 35 mijë vendeve të reja pune, uljen e mëtejshme të shkallës së papunësisë poshtë nivelit 11%; sigurimin e një niveli të lartë të investimeve publike mbi 4,5% të produktit të brendshëm bruto, në mbështetje të rritjes ekonomike dhe punësimit; ruajtjen e balancës primare pozitive. Ky bilanc do të jetë pozitiv për të pestin vit radhazi në nivelin 0,7%, duke synuar mbajtjen e borxhit në trajektoren rënëse.

Në fund të vitit 2020 borxhi publik pritet të ulet në nivelin 62,2% të produktit të brendshëm bruto për të zbritur poshtë 60% në vitin 2021, konkretisht në 59% dhe në vitin 2022 në 57%.

Mbajtja e deficitit buxhetor nën nivelin e 2%

Për vitin 2020 planifikohet të jetë në nivelin 1,6% të produktit të brendshëm bruto, niveli më i ulët i targetuar në 2 vjetët e fundit.

Përpara parashtrimit të risive të projektbuxhetit 2020, po sjell në vëmendje zhvillimet ekonomike në nivel të përgjithshëm.

Këtë vit ekonomia ka vijuar të regjistrojë rritje pozitive gjatë gjysmës së parë të vitit 2019, në nivelin e 2,4%. Pavarësisht ngadalësimit të rritjes, faktorët kryesorë, të cilët kanë realizuar që sektorët fundamentalë strukturorë të ekonomisë, kanë pasur një rritje në linjë me pritshmëritë për të mundur një rritje në intervalin 3%- 3,5% për të gjithë vitin 2019.

Në gjysmën e parë të vitit 2019 konsumi final regjistroi një rritje reale prej 2,7%, duke vijuar të njëjtin trend pozitiv sikurse viti paraardhës.

Nga pikëpamja e kërkesë agregate pritet që rritja për periudhën afatmesme në vijim të gjenerohet kryesisht nga kërkesa e brendshme, si konsumi ashtu edhe investimet. Edhe kërkesa e huaj neto parashikohet të japë një kontribut pozitiv, ndonëse në nivele më të moderuara se kontributi që do vijë nga kërkesa e brendshme.

Më specifikisht, në vitin 2020 parashikohet që konsumi total të rritet në terma reale me rreth 2,5% duke dhënë një kontribut prej 2,3 pikë përqindje në rritjen e produktit të brendshëm bruto; investimet totale të rriten me 4,3% ose me kontribut me rreth 1 pikë përqindje, ndërsa kërkesa e huaj neto (eksporte-importe) parashikohet të përmirësohet me rreth 5% ose me një kontribut pozitiv prej 0,8 pikë përqindje në produktin e brendshëm bruto.

Në anën e ofertës agregate, kontributi pozitiv u atribuohet të gjithë sektorëve, kryesisht tij të shërbimeve, veçanërisht tregtisë, hotelerisë dhe transportit, në reflektim edhe të performancës së turizmit, i ndjekur nga sektori i bujqësisë dhe nga ai i industrisë.

Tregu i punës ka shfaqur një ulje të mëtjshme të shkallës së papunësisë nën nivelin 12% në 3-mujorin e dytë të këtij viti, niveli më i ulët i regjistruar në dy dekadat e fundit.

Punësimi u rrit me 3,3%, e ushqyer kjo kryesisht nga rritja e shkallës së pjesëmarrjes në forcat e punës. Rritja e punësimit është kyçe për gjenerimin e të ardhurave të disponueshme në familjeve dhe, për rrjedhojë, për të nxitur konsumin, kursimet në investime dhe rritjen e mëtjshme të ekonomisë.

Indeksi 3-mujor i ndjeshmërisë ekonomike ka ndjekur përgjithësisht një trend pozitiv gjatë 3-mujorëve të këtij viti, kundrejt fundvitit të kaluar, dhe qëndron konsiderueshëm mbi mesataren afatgjatë të tij. Kjo është një premisë mjaft e rëndësishme për një sjellje dhe vendimmarrje aktive për të investuar dhe konsumuar.

Kreditë me probleme kanë vijuar të ulen tashmë në nivelin 11%, nga 24% që ishte disa vjet më parë. Gjithashtu, kreditimi i sektorit privat ka regjistruar një rritje prej 7% kundrejt një viti më parë, e cila i atribuohet si kredisë ndaj bizneseve, ashtu edhe atyre konsumatore për individë.

Më tej, në vitin 2019 ka pasur një zgjerim të deficitit të llogarisë korrente për gjysmën e parë të këtij viti, duke reflektuar kryesisht importe më të larta të mallrave me plus 3% dhe një tkurrje të eksporteve me 2,8% në 9-mujorin e vitit 2019, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Thellimi i deficitit tregtar gjatë gjysmës së parë të vitit është kompensuar në një masë të konsiderueshme nga rritja e suficitit të balancës së shërbimeve, ku reflektohet kryesisht performanca mjaft e mirë e shërbimeve të turizmit edhe gjatë këtij viti.

Në të njëjtën kohë, flukset e larta të investimeve të huaja direkte me një rritje prej 10% kundrejt një viti më parë, kanë sjellë një zgjerim të suficitit të llogarisë financiare dhe kapitale. Për rrjedhojë, bilanci i përgjithshëm i pagesave dhe pozicioni i jashtëm i ekonomisë mbetet i qëndrueshëm.

Konsolidimi fiskal është materializuar në një trajektore pozitive për borxhin publik dhe deficitin buxhetor me pritshmëri nën 2% nga 5% të produktit të brendshëm bruto në vitin 2013.

Rezultatet paraprake fiskale deri në tetor të vitit 2019 tregojnë se realizimi i përgjithshëm i buxhetit mbetet plotësisht në përputhje me objektivat dhe parametrat kryesorë fiskalë. Ka pasur një mungesë të të ardhurave prej rreth 1,8%, në krahasim me planin e

periudhës, sidoqoftë, një mungesë e tillë e të ardhurave është absorbuar plotësisht brenda hapësirave amortizuese të krijuara që në buxhetin fillestar.

Arritja e plotë e objektivave kryesorë fiskalë: objektivi fillestar i deficitit të përgjithshëm prej 1,9% e produktit të brendshëm bruto, një bilanc primar pozitiv dhe një ulje të borxhit prej rreth 2 pikë përqindje, mbetet mjaft e sigurt.

Rrjedhimisht, bazuar në sa më sipër, vlerësojmë se ekzistojnë të gjitha premiset për një rritje ekonomike në fashën e 4 përqindëshit si në vitin 2020, ashtu edhe për periudhën afatmesme në vijim. Është e vendosur në një perspektivë rajonale dhe rezulton se rritja ekonomike e Shqipërisë ka ndjekur një trajektore rritëse të qëndrueshme që prej vitit 2013, duke e tejkaluar dhe mesataren e rajonit në 3 vjetët e fundit. Po ashtu, edhe norma e papunësisë në Shqipëri vijon të mbetet poshtë mesatares së rajonit.

Parashikimi i të ardhurave për buxhetin e 2020 është bazuar në vlerësimin rigoroz të rezultatit të pritshëm për vitin 2019. Në parashikimin e të ardhurave janë faktorizuar në mënyrë të ndërlidhur edhe variablat makroekonomikë me faktorët kryesorë që ndikojnë në taksa specifike.

Elementët kryesorë që janë faktorizuar në parashikimin e të ardhurave, janë: rritja nominale e produktit të brendshëm bruto, duke e analizuar këtë efekt në mënyrë të integruar me faktorë të tjerë për çdo taksë në veçanti, të ndërlidhur me të dhënat historike, si dhe me projeksionet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare me impakt tek taksat *ad-valorem*, si tatimi mbi vlerën e shtuar, renta minerare dhe taksa doganore.

Kursi i pritshëm i këmbimit

Sasitë e pritshme të importit të mallrave në përgjithësi dhe atyre me regjim akcize në veçanti, si dhe programimi i fondeve të nevojshme për rimbursimin e tatimpaguesve, kanë qëllim uljen e stokut në fund të vitit 2020 me rreth 67 %, krahasuar me stokun e pritshëm në fundin e vitit 2019.

Të ardhurat totale të buxhetit të shtetit në fund të vitit 2019 pritet të jenë rreth 474 miliardë lekë, këto krahasuar me vitin 2018. Rritja rezulton +5,3% ose 24 miliardë lekë më shumë. Totali i të ardhurave të pritshme në raport me produktin brendshëm bruto në fund të këtij viti rezultojë 27,8%, nga 27,6 % që ishte në vitin 2018.

Rritja me plus 0,2 pikë përqindjeje ndaj prodhimit të brendshëm bruto e të ardhurave të buxhetit të shtetit është tregues i përmirësimit edhe në mbledhjen e të ardhurave dhe luftës ndaj informalitetit, e cila ka kompensuar edhe disa faktorë të përkohshëm me efektete

negative. Të ardhurat totale për vitin 2020 parashikohen me një rritje prej 6,2% mbi të ardhurat e pritshme të vitit 2019 ose rreth 29,2 miliardë lekë më shumë.

Shpenzimet buxhetore të programuara për vitin 2020 janë rreth 532 miliardë lekë ose rreth 29,7% e produktit të brendshëm bruto. Ato rriten me rreth 5,1% krahasuar me të pritshmin e vitit 2019.

Prioritet në buxhetin e vitit 2020 mbetet mbështetja për sektorët prioritarë, si arsimi, shëndetësia, bujqësia dhe infrastruktura. Këto sektorë janë kyçë në ecurinë e një modeli ekonomik, që sjell zhvillim të qëndrueshëm dhe ndikon në jetesën e qytetarëve.

Sektorët prioritarë të konsideruara në veçanti me fillimin e projeksioneve, të cilave në zërin kryesor të arsimit u alokohen 3,3 miliardë lekë më shumë se buxheti viti 2019. Arsimi është një sektor, i cili duke filluar nga viti 2019 u rrit në mënyrë të ndjeshme si rezultat dhe falë të gjithë mbështetjes së vazhdueshme për studentët në kuadër të “Paktit të universitetit”, por edhe më tej. Në vitin 2020 tekste shkollore do të jepen falas për rreth 230-250 mijë nxënës të arsimit parauniversitar nga shtresat sociale në nevojë me një efekt prej rreth 500 milionë lekësh në vit; trajtimi me kuotë ushqimore për 1300-1400 nxënës të arsimit parauniversitar nga shtresat sociale në nevojë; investimi në arsim mesatarisht 750 milionë lekë në vit përgjatë 2020-2022; 2 herë më tepër, nga 340,5 milionë në vit që kanë qenë më parë; sikurse mbështetja e vazhdueshme për studentët në kuadër të “Paktit me universitetin”.

Spektori i dytë, po aq i rëndësishëm dhe me një mbështetje më të lartë buxhetore është sektori i shëndetësisë, i cili do të ketë 2,75 miliardë lekë më tepër se viti 2019.

Ky buxhet do të mbështesë:

Rikonstruktionin e 120 qendrave shëndetësore për vitin 2020, me një vlerë prej 350 milionë lekësh; ilaçe të rimbursuar për 1000 pacientë më shumë se një vit më parë, përgjatë 2020-2022; efektivitet të shtuar në shërbimet shëndetësore, kryesisht reduktimin e kohës aktuale prej 45 ditësh të pritjes për ekzaminime të rëndësishme si: rezonancë, skaner e të tjera.

Spektori i tretë prioritar dhe i rëndësishëm është bujqësia, që i alokohen 1,8 miliardë lekë më shumë se në vitin 2019 ose rreth 12% më tepër. Spektori i bujqësisë pritet të rrisë produktivitetin dhe konkurrueshmërinë e produkteve bujqësore dhe blegtorale përgjatë periudhës 2020-2022, duke përmirësuar standardet, duke garantuar sigurinë ushqimore dhe zhvillimin e zonave rurale përmes nxitjes së shumëllojshmërisë së veprimtarive ekonomike në këto zona.

Shpenzimet kapitale ose investimet publike do të pësojnë një rritje 4,7% në raport me PBB-në dhe rreth 4%, krahasuar me të pritshmin e këtij viti.

Në planifikimin e investimeve për vitin 2020 janë mbajtur në konsideratë të gjitha detyrimet kontraktuale për projektet e investimeve me financim të huaj dhe të brendshëm. Ashtu si në vitin 2019, edhe në vitin 2020 do të ketë përparësi financimi i projekteve në vazhdim, duke synuar mbylljen e tyre brenda vitit 2021.

Për sa i përket infrastrukturës rrugore, për periudhën 2020-2022, synohet kompletimi i akseve rrugore nacionale dhe segmenteve rrugore, si: Rruga e Arbrit, Milot – Balldren dhe Orikum – Dukat, brenda vitit 2022; kompletimi i pjesës dërmuese të segmenteve rrugore në vazhdim me financim të brendshëm brenda vitit 2022, si: Kardhiq – Delvinë, Elbasan – Banjë, bajpasi i Shkodrës, bajpasi i Tepelenës dhe një pjesë e mirë e Unazës së Tiranës; kompletimi i segmenteve rrugore brenda vitit 2021 me financim të huaj, si: bajpasi i Fierit, bajpasi i Vlorës dhe Qukës – Qafë Plloçë.

Qeveria shqiptare synon në vazhdimësi reduktimin e numrit të aksidenteve me pasojë humbje jetë njerëzish dhe numri i pikave të zeza me 25%.

Balanca korrente fiskale për këtë vit programohet gjithashtu ndër nivelet më të larta të dy dekadave të fundit, prej 311% të PBB-së, ndryshe, për 100 lekë të marra borxh programohen 286 lekë investime publike. Ky raport është i përmirësuar ndjeshëm krahasuar me mesataren e këtij treguesi për periudhën e mëparshme.

Në fushën e sigurisë kombëtare kemi rritur buxhetin e mbrojtjes me rreth 2,8 miliardë lekë më shumë krahasuar me buxhetin e vitit 2019 për të garantuar realizimin e objektivit të qeverisë dhe angazhimet tona në NATO për 2% të PBB-së për vitin 2024 si buxhet për Ministrinë e Mbrojtjes.

Ky buxhet, gjithashtu, plotëson të gjitha nevojat financiare të institucioneve të reja të krijuara nga paketa e reformës në drejtësi si: KLP-ja, KLGJ-ja, Byroja e Hetimit dhe SPAK-u, duke akomoduar plotësisht edhe financimin për reformën në drejtësi dhe duke mundësuar burimet e nevojshme financiare për pagat e rritura të magjistratëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.

Më tej buxheti alokon një fond të rëndësishëm për shpenzimet e personelit, të programuara në masën 83,5 miliardë lekë për vitin 2020, ku, përveç financimit të plotë të kostos aktuale të administratës publike qendrore, faktorizohen gjithashtu edhe efektet e plota të politikës së rritjes së pagave për sektorin e shëndetësisë, arsimit, mbrojtjes, sistemit penitenciar dhe punonjësit e përfaqësive diplomatike, të cilat u realizuan në muajin prill të këtij viti; shpenzimet operative dhe mirëmbajtjes, të programuara në vlerën 50 miliardë lekë, duke prioritetizuar mbështetjen e skemës së fermerëve, mirëmbajtjen e sistemeve të teknologjisë së informacionit në administratën publike, si dhe mirëmbajtjen e rrjetit rrugor

kombëtar; shpenzimet për interesa, të cilat parashikohen në nivelin 40,9 miliardë lekë ose 2,3% të PBB-së, të cilat përfshijnë kontigjenca të mjaftueshme për të përballuar edhe nëse do të kishte një rritje të normave të interesit nga 1 deri në 2 pikë përqindje mbi nivelin aktual, edhe pse ne pretendojmë se do të jetë më i ulët se i mëparshmi; subvencionet, të programuara në rreth 1,3 miliardë lekë. Këtu është faktorizuar rialokimi i një pjese të mirë të subvencionit të parashikuar për ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizime tek investimet publike për rehabilitimin dhe ndërtimin e rrjeteve të ujësjellës-kanalizimeve, në kuadër të përsheptimit të reformës së ndërmarrë nga qeveria për këtë sektor.

Shpenzimet e fondeve speciale për vitin 2020, të cilat përfshijnë shpenzimet totale për fondet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe kompensimin në vlerë të ish-pronarëve janë planifikuar në vlerën prej 188,6 miliardë lekësh.

Niveli i shpenzimeve për skemën e sigurimeve shoqërore për vitin 2020 parashikohet në masën 137,5 miliardë lekë ose 7,7% e PBB-së, raport thajse i njëjtë me vitin 2019, nga e cila për indeksimin e pensioneve është parashikuar një fond prej 2,52 miliardë lekë. Siç e kam theksuar edhe më herët, kjo skemë i rëndon më pak buxhetit të shtetit se disa më parë. Kjo për shkak të uljes së nivelit të informalitetit në tregun e punës dhe rritjes së nivelit të punësimit në ekonomi.

Në skemën e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2020 janë parashikuar rreth 44 miliardë lekë ose 2,5% e PBB-së nga rreth 42 miliardë lekë të parashikuara në fund të vitit 2019.

Fondi për kompensimin në vlerë të pronarëve parashikohet në total rreth 4,5 miliardë lekë nga rreth 1,9 miliardë lekë që ishte në vitin 2013. Rritja e fondit të kompensimit në vlerë të pronarëve bëhet në mbështetje të reformës së ndërmarrë nga qeveria për trajtimin e ish-pronarëve, pjesë e së cilës është edhe kompensimi në vlerë për t'u realizuar brenda periudhës 10-vjeçare të parashikuar në ligjin nr.133/2015.

Shpenzime të tjera sociale janë programuar në masën 24,6 miliardë lekë, të cilat përfshijnë: shpenzimet për pagesën e papunësisë, në nivelin 600 milionë lekë; shpenzimet për pagesën e ndihmës ekonomike dhe personave me aftësi të kufizuar në nivelin 21 miliardë lekë; për ish-të përndjekurit është parashikuar një fond prej 1 miliard lekë; për bonusin e lindjeve sërish është parashikuar një fond prej 2 miliardë lekësh. Edhe këtë vit pritet të përfitojnë rreth 30 mijë familje nga kjo politikë.

Niveli i fondit rezervë për vitin 2020 planifikohet të jetë në masën 1,7 miliardë lekë, përkatësisht: 1,4 miliardë lekë fond rezervë i Këshillit të Ministrave dhe 300 milionë lekë fond kontigjence për financimin e reformës në sistemin e drejtësisë.

Buxheti i pushtetit vendor për vitin 2020 është programuar në rreth 57 miliardë lekë, rreth 11,2 përqind më i lartë se ai i 2019-ës ose rreth 5,7 miliardë lekë më shumë fonde për shërbime dhe investime publike vendore. Kjo rritje prej 3,2% në raport me PBB-në i shërben konsolidimit të procesit të menaxhimit të financave vendore, zbatimit të reformës administrativo territoriale, decentralizimit fiskal të njërive të vetëqeverisjes vendore dhe uljes së stokut të detyrimeve të prapambetura të trashëguara nga ndarja e vjetër territoriale.

Së fundi, më lejoni të ritheksoj se Ministria e Financave dhe Ekonomisë në këtë projektbuxhet është angazhuar të shmangë dhe eliminojë risqet që burojnë nga faktorët e jashtëm dhe të brendshëm të ekonomisë, duke shfrytëzuar rolin e saj vendimmarrës në kontekstin e menaxhimit të financave publike, mbikëqyrjes së risqeve që burojnë nga PPP-të, apo huamarrjes, ecurinë e ekonomisë botërore, realizimin e të ardhurave apo kursin e pafavorshëm të këmbimit dhe, mbi të gjitha, konsolidimin fiskal në vijueshmëri.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Ministre!

Si relator, po avancojmë me opinionin për vlerësimin në parim të projektligjit për buxhetin e vitit 2020.

Projektligji për buxhetin e viti 2020 është propozuar nga Këshilli i Ministrave, mbështetur në nenet 158 dhe 159 të Kushtetutës, në neni 29 të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Shqyrtimi i këtij projektligji bëhet sipas procedurave të përcaktuara në nenet 78 dhe 84 të Rregullores së Kuvendit. Që nga viti 2015 projektbuxheti vjetor paraqitet si pjesë e programit buxhetor afatmesëm, duke përcaktuar dhe harmonizuar politikat, prioritetet dhe treguesit për vitin e ardhshëm me ato të periudhës afatmesme 2020-2022.

Politikat, treguesit dhe objektivat e projektbuxhetit mbështeten në strategjinë e menaxhimit të financave publike 2014-2020; kuadrin makroekonomik e fiskal afatmesëm 2020-2022; programin e qeverisë; politikat dhe prioritetet e zhvillimit të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë; ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe aktet nënligjore përkatëse të tij.

Projektbuxheti ka në themel objektivat e kuadrit makroekonomik e fiskal afatmesëm për tre vjetë në vijim: ruajtjen dhe konsolidimin e mëtejshëm të stabilitetit makroekonomik të vendit; krijimin e klimës për një rritje të lartë e të qëndrueshme ekonomike dhe konvergimin sa më shpejt drejt nivelit mesatar të mirëqenies së Bashkimit Europian.

Kuadri makroekonomik e fiskal afatmesëm përcakton edhe drejtimet kryesore për realizimin e këtyre objektivave, të cilat janë: targetimi i një trajektoreje rënëse të borxhit

publik, duke synuar nivelin e borxhit publik neto poshtë 60 përqindëshit të PBB-së në vitin 2021 dhe rreth nivelit 57% në vitin 2022; mbajtja e një niveli të investimeve publike mbi nivelin e deficitit të përgjithshëm fiskal në çdo vit dhe mundësisht afër nivelit optimal prej 5% të PBB-së; harmonizimi me objektivin themelor të politikës monetare për stabilitetin e çmimeve, e cila targeton një normë inflacioni në nivelin 3% dhe ankorimin e pritshmërive të tij rreth këtij niveli; zbutja e deficitit të llogarisë korrente dhe përmirësimi i pozicionit të jashtëm të ekonomisë, duke tentuar rritjen graduale të nivelit të rezervave valutore dhe duke ruajtur të paktën një nivel dysheme të tyre, të mjaftueshëm për të financuar jo më pak se 4 muaj import mallrash dhe shërbimesh.

Projektbuxheti mban në konsideratë vlerësimet dhe rekomandimet e institucioneve financiare ndërkombëtare të Komisionit Europian, FMN-së, Bankës Botërore, si dhe të agjencive ndërkombëtare, të cilat mbikëqyrin ekonominë e vendit tonë. Politikat dhe treguesit e tij, si çdo vit, janë konsultuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Institucionet financiare ndërkombëtare kanë vlerësuar se ekonomia shqiptare po vijon të zhvillohet me ritme pozitive, por më të ngadalta se parashikimet, duke analizuar edhe faktorët, që kanë ndikuar në këto rezultate. Ky ritëm pritet të përshpejtohet gjatë periudhës afatmesme, por me nivel më të ulët se parashikimet në fillim të vitit. Përshpejtimi i rritjes ekonomike parashikohet të vijë nga rritja e investimeve publike e private, përmirësimi i shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese, si dhe vijimi i reformave strukturore, veçanërisht në sistemin e drejtësisë dhe sektorin financiar. Inflacioni ka qenë në rënie që prej vitit 2018, por me rritjen e ekonomisë ai pritet të arrijë afër mesatares historike gjatë gjysmës së dytë të vitit 2021. Pavarësisht ngadalësimit të rimit të rritjes ekonomike, papunësia pësoi ulje, ndërsa punësimi dhe paga reale u rritën. Konsolidimi fiskal vijon duke u reflektuar në reduktimin e deficitit fiskal dhe të raportit të borxhit publik ndaj PBB-së. Vijimi i konsolidimit fiskal, i kombinuar me përshpejtimin e rritjes ekonomike, priten të sjellin reduktimin e raportit të borxhit publik ndaj PBB në 60 % të PBB-së dhe pas vitit 2022 në rreth 56-57%. Politikat e lehtësimit monetar vijnë edhe përmirësimet në portofolin e kredisë, ku kemi vënë re një rritje të kreditimit për sektorin privat. Sektori bankar është i mirëkapitalizuar dhe fitimprurës. Gjithashtu, institucionet financiare ndërkombëtare kanë evidentuar faktorët që mund të ndikojnë negativisht në realizimin e objektivave të programuara, si dhe masat që duhet të ndërmerren për zbutjen e ndikimit të tyre. Disa prej masave më të rëndësishme janë përmirësimi i administrimit të të ardhurave dhe maksimizimi i tyre, rritja e efikasitetit të shpenzimeve, si dhe përmirësimi i mjedisit të biznesit.

Politikat dhe treguesit e projektbuxhetit mbështeten në trendin e zhvillimit të ekonomisë së vendit në vite, zhvillimet ekonomike të deritanishme dhe ato të pritshme për vitin 2019, si dhe pritshmëritë për zhvillimin afatmesëm.

Zhvillimet ekonomike gjatë vitit 2019.

Nga vitin 2013 deri në vitin 2018 ekonomia e vendit u zhvillua me ritme pozitive dhe me një trend në rritje. Rritja ekonomike arriti nga 1 % në vitin 2013 dhe u mbyll me 4,1% në vitin 2018. Edhe gjatë vitit 2019 ekonomia vijoi rritjen pozitive, por me një ritëm më të ulët se vitet e mëparshme. Sipas parashikimit të Ministrisë së Financave, ritmi i rritjes reale të PBB-së këtë vit pritet të jetë 3-3,5%. Njoftoj Ministrinë e Financave të rishikojë pozicionimin në lidhje me rritjen ekonomike të 6-mujorit të dytë, sepse ky 6-mujor duhet të jetë të paktën 5% që rritja ekonomike vjetore të shkojë 3-3,5%. Ftoj departamentin makroekonomik që të reflektojë rritjen ekonomike të vitit 2018 në parashikimet e vitit 2019, me këtë logjikë matematike që ju e njihni prej kohësh shumë mirë, që do të thotë se rritja ekonomike e 6-mujorit duhet të shkojë 5%, në mënyrë që rritja vjetore të shkojë 3-3,5%, ose duhet të përmirësojmë relacionin, ku ju të pozicionoheni konkretisht pse mendoni se do të jetë 3-3,5%, pra, qoftë e parë në aspektin e ofertës, qoftë e parë në aspektin e kërkesës. Kjo është shumë e rëndësishme për deputetët për të reflektuar për pritshmërinë e vitit 2019, por në të njëjtën kohë për të konsoliduar pritshmërinë e vitit 2019 në reflektim me planifikimin e vitit 2020.

Parashikimi më i fundit i Bankës Botërore është që rritja ekonomike në vitin 2019 të jetë midis 2,8 -2,9%, duke u rritur më tej në periudhën afatmesme, por me rritje më të ulëta se parashikimi në fillim të vitit. Gjithashtu, Banka Botërore parashikon që rritja ekonomike në Shqipëri të jetë në nivel më të ulët se vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor: Bosnjë-Hercegovina 3,1%; Kosova 4%; Maqedonia e Veriut 3,1%, Serbia 3,3%. Do të ftoja Ministrinë e Financave, nëse ka hapësirë, të reflektonte edhe një herë për 4,1%-shin që ka prezantuar si një nga *bench* makroekonomikë për planifikimin e buxhetit të vitit 2020.

Rritja ekonomike gjeneruar kryesisht nga zgjerimi i kërkesës së brendshme si rezultat i rritjes së konsumit dhe investimeve.

Përmirësimi i kushteve të kreditimit dhe shpenzimet qeveritare në infrastrukturë rriten investimet dhe ritmet e rritjes ekonomike.

Ndikimi në rritjen e investimeve dhe zhvillimet në projektin TAP, kontribut mjaft pozitiv dhe arritja me 10% e investimeve të huaja direkte.

Investimet e vitit 2019, krahasuar me një vit më parë janë rritur në vlerë absolute, por ritmi i rritjes së tyre është ndjeshëm më i ulët se një vit më parë, se viti 2018.

Në përqindje ndaj prodhimit të brendshëm bruto investimet janë reduktuar nga 4,8% e PBB-së në vitin 2018, në 4,7% të PBB-së në vitin 2019. Duke iu referuar asaj që ministrja tha, që rritja ekonomike mbështetet nga investimet publike, është e pajustificueshme që rritja e investimeve kapitale në buxhet në raport me PBB-në të vazhdojë të ulet në afatmesëm.

Ftoj Ministrinë e Financave dhe qeverinë të reflektojnë në planifikimin afatmesëm për të bërë të mundur që qeveria, si një nga aktorët ekonomikë, të funksionojë, të kontribuojë me investime publike të zgjuara në infrastrukturë dhe jo vetëm, në funksion të rritjes ekonomike, aq më tepër që për herë të parë, pas shumë e shumë tremujorësh, viti 2019 reflektoi rënie të formimit të kapitalit fiks bruto, që për qytetarët presupozon investime dhe për herë të parë reflekton një rritje shumë modeste të eksporteve, rreth 3%, të importeve rreth 3%, ndërkohë që eksportet kanë për herë të parë kanë gati rritje negative, krahasuar me shumë periudha sidomos me atë të vitit 2018, kur rritja e eksporteve shkoi rreth 16,8%, vit për vit.

Përmirësimi i punësimit, rritja e pagave dhe e kredisë konsumatore nxitën konsumin privat duke kontribuar pozitivisht në rritjen ekonomike. Norma e papunësisë arriti në nivelin më të ulët historik në 11,4%.

Ritmi i rritjes së vendeve të punës u përshpejtua duke u krijuar më shumë vende pune në sektorët e shërbimeve dhe në bujqësi. Megjithatë, duhet theksuar, se ky është viti i parë në ekonomi që rritja e vendeve të punës në sektorin jobujqësor ishte vetëm rreth 5000 vende pune. Pra, po ta krahasosh me vitet e tjera, praktikisht ka një ngadalësim të rritjes së vendeve të punës në sektorin jobujqësor.

Pagat reale u rritën mesatarisht me 3,4%, kryesisht në sektorët e shërbimeve, tregti, transport dhe turizëm.

Nga pikëpamja e ofertës agregate, rritja ekonomike u mbështet në zhvillime pozitive në sektorët e shërbimeve dhe ndërtimit.

Ngadalësimi i ritmit të rritjes ekonomike gjatë vitit 2019 ishte rrjedhojë, dhe jo vetëm, kryesisht e rënies së prodhimit të energjisë elektrike, por edhe e zvogëlimit të ritmit të rritjes së konsumit apo disa sektorë, siç ishte ndërtimi, që reflektuan jo pozitivisht në 6-mujorin e parë.

Gjithashtu, kontribut negativ ka sjellë edhe ngadalësim në përfundimin e punimeve në projektin gazsjellës TAP.

Ndikim negativ, siç iu referova, pati edhe reduktimi i eksportit neto të mallrave për shkak të stanjacionit, gjithashtu, të rritjes ekonomike në vendet partnere tregtare.

Megjithatë, faktorët që kanë sjellë reduktimin e rritjes ekonomike konsiderohen të luhatshëm dhe unë shpresoj të përkohshëm.

Në rritjen e ekonomike për këtë vit ndikojnë edhe tregues të tjerë themelorë të ekonomisë, si vijim i performancës pozitive, siç iu referova, të tregut të punës, perceptimi pozitiv i bizneseve, me gjithë negativitetin në 3-mujorin e parë, një përmirësim në 3-mujorin e dytë.

Forcimi i stabilitetit financiar dhe përshpejtimi i kreditimit të ekonomisë, forcimi i pozicionit të jashtëm të ekonomisë dhe përmirësimi i bilancit të pagesave, thellimi i konsolidimit fiskal dhe forcimi i qëndrueshëm i financave publike, duke analizuar tërësinë e faktorëve që ndikojnë në rritjen ekonomike, parashikimet janë që ajo të përshpejtohet në periudhën afatmesme, megjithatë unë pres një reflektim nga Ministria e Financave për sa i përket 4,1%-shit.

Nga çka kam diskutuar me kolegët ka gati 100 pyetje, kështu që besoj se do t'i bëjnë një nga një këtu dhe pastaj do t'ua dorëzojmë me shkrim, që Ministria e Financave të marrë kohën e vet për përgjigjet.

Edhe gjatë vitit 2019 vijon politika e konsolidimit fiskal, e cila shprehet nëpërmjet treguesve, si më poshtë:

- deficit i buxhetor parashikohet të jetë nën 2% të PBB-së;
- balanca primare fiskale vijon të jetë pozitive në 0,2% e PBB-së;
- balanca korrente fiskale vijon të jetë pozitive në 2,8% e PBB-së, megjithatë me një rënie të lehtë nga vitet e mëparshme.

- Borxhi publik parashikohet të jetë në rënie nga 67,9% në 65% në vitin 2018 në 65,5%, më rezulton se (kjo është edhe një nga pyetjet që kishte një nga deputetët) në qoftë se kombinimi mes gjendjes së TSA-së, llogarisë së qeverisë më 31 dhjetor, dhe kursi i këmbimit të jetë rreth 1,8%, me një rënie të borxhit prej 2,4%, i bie që konsolidimi të jetë afërsisht rreth 0,7% e PBB-së. Këtë besoj se do të na e shpjegoni, por mua më rezulton, nëse është kështu, ngadalësim i konsolidimit.

Norma mesatare e inflacionit u reduktua nga 2% në vitet 2017-2018, në 1,55 në vitin 2019. Faktorët kryesorë që ndikuan në këtë rënie janë niveli i ulët i inflacionit të importuar nga vendet partnere tregtare dhe mbiçmimi i lekut.

Gjithashtu, presionet e brendshme të inflacionit ishin të dobëta për shkak të vijimit të shfrytëzimit jo të plotë të kapaciteteve prodhuese.

Banka e Shqipërisë, në përputhje me objektivin për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe për të zvogëluar ndikimin e mbiçmimit të lekut në çmimet e brendshme, mbajti normën bazë të interesit në nivelin më të ulët historik prej 1%, që nga qershori i vitit 2008.

Përmirësimet në portofolin e kredisë filluan të ndikojnë në rritjen e kreditimit të sektorit privat, megjithatë kreditimi për bizneset është ende i kufizuar dhe duhet të stimulohet nga një gamë më e gjerë instrumentesh financiare.

Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit për vitin 2019 u realizua në masën 97,3% në krahasim me planin me një mosrealizim prej 13,3 miliardësh.

Gjithsesi, unë kam një lutje për Ministrinë e Financave që të rishikojë të pritshmin, në mënyrë që diskutimi për të ardhurat e vitit tjetër të jenë më solid, por besoj se do të kemi kohë gjatë gjithë kësaj periudhe të diskutojmë së bashku dhe duke iu referuar edhe axhendës së parlamentit do të kemi edhe një të dhënë më të saktë se ajo që mund të parashikojmë sot, kur të kemi të dhënat operative të mbylljes së 11-mujorit, (të nëntorit dhe të 11-mujorit) gjë që do të na bëjë të gjykojmë së bashku në mënyrë më realiste për të ardhurat, mbi të gjitha, për deficitin e këtij viti, nëse ka risk, për investimet publike të këtij viti, nëse ka risk, për bonusit e pensionistëve, nëse do të realizohet.

Më pas, së bashku, meqë buxheti ka ardhur pa një *headline*, siç është në traditë (për shembull viti 2018 ishte buxheti i infrastrukturës, viti 2019 ishte buxheti i konsolidimit fiskal dhe rritjes së pagave të mësuesve, të mjekëve, infermierëve, diplomatëve dhe ushtarakëve), do të mundohemi së bashku t'i vëmë një *headline* buxhetit. Pra, do ta quajmë “buxheti i infrastrukturës” dhe do ta diskutojmë se bashku, do ta quajmë “buxheti i rritjes së pensione” dhe do ta shohim nëse ka dhe do ta diskutojmë së bashku, do ta quajmë “buxheti i rritjes së pagave” do ta shohim dhe do ta diskutojmë së bashku, do ta quajmë “buxheti i rritjes së të ardhurave” do ta shohim dhe do ta diskutojmë së bashku, do ta quajmë “buxheti i rritjes së cilësisë së arsimit universitar ose parauniversitar” do ta shohim dhe do ta diskutojmë së bashku. Pra, meqë buxheti ka ardhur pa një *headline*, shpresoj që qeveria të reflektojë në ditët e ardhshme që t'i vendosim një *headline* buxhetit. Le ta gjykojmë së bashku me ministren, në bazë të asaj që do të reflektojmë në shifra gjatë diskutimit në parim dhe nën për nen, në mënyrë që kur ta paraqesim në Kuvend, unë do të kisha shumë dëshirë (edhe me komisionin e diskutuam sot në mëngjes), që t'i vendosim një *headline* të rëndësishëm në varësi të shifrave.

u heq vërejtje punonjësve të Ministrisë së Financave, jo ministres, se për të është buxheti i parë, se buxheti nuk vjen pa *headline* për qytetarët e Republikës së Shqipërisë.

Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit të vitit 2019, siç e theksova, në krahasim me një vit më parë, vlerësohen të rriten në 5,2%. Sipas vlerësimeve të Ministrisë së Financave të ardhurat e përgjithshme të buxhetit të shtetit në vitin 2019 përbëjnë 27,8% të PBB-së, duke u rritur me 0,2%.

Këtu dua të përmend disa elemente shumë të rëndësishme për sa i përket të ardhurave, të cilat janë të domosdoshme të mbahen në diskutimin në vazhdimësi. Ajo që vihet re për vitin 2019, meqë i referohemi këtij viti edhe në vlerësim, por edhe në fjalën e ministres në Konferencën e Kryetarëve, iu referuam të ardhurave të pritshme, të cilat unë i konsiderova s një ankorë zyrtare për të diskutuar më tej. Është e vërtetë që i pritshmi i vitit 2019 është 27,8, ku 0,8% e gjithë 27,8%-shit janë ndihmat dhe këtu sërish i them Ministrisë së Financave të bëjë një rivlerësim nëse ndihmat do të jenë deri në fund në atë nivel.

E dyta, ka një rënie të të ardhurave nga tatimet e doganat, nga 18, 7 % në 18, 4 %, megjithëse rritja ekonomike dhe nominalja është më e ulët se ajo që keni planifikuar para një viti e ca. Ajo që më shqetëson në afatmesëm, është trendi modest i rritjes së të ardhurave nga tatimet dhe doganat.

Besoj se gjatë diskutimeve që do të bëjmë me njëri-tjetrin, do të kemi një justifikim të qenësishëm në lidhje me arsyen se përse në përqindje të prodhimit të brendshëm bruto të ardhurat nga tatimet e doganat kanë rënë nga 18, 7 në 18, 4. Do t'ju ftoj të bënim një vlerësim. Pashë se një nga pyetjet e kolegëve, ishte se çfarë do të ndodhte nëse nuk do të kishim të ardhurat nga dividendi, që solli rreth 8 miliardë plus në buxhet nga tradita. Gjithsesi, këto janë në reflektim të pyetjeve që kanë bërë kolegët.

Për sa u përket shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit, në vitin 2020 parashikohet të realizohen në masën 97, 4 %, këtu do t'ju bëja thirrje, zonja Ministre, meqë keni shënuar një mosrealizim prej 13, 3 miliardë lekësh, në krahasim me planin, nëse jam korrekt. Do t'ju lutesha që kjo shumë të mos kursehet, por të shkojë për pagesën e detyrimeve të prapambetura të Ministrisë së Infrastrukturës, që sot janë 6, 2 miliardë, duke iu referuar asaj që unë shoh në 2019-ën dhe asaj që ministria planifikon për 2020-ën, me ato të dhëna ku investimet publike të Ministrisë së Infrastrukturës në transport rrugor janë ulur me gati me 1, 8 miliardë.

Moza, mos e tund kokën, sepse ti je kontributorë në atë gërshtë, e që s' duhej të ishte.

Praktikisht, aty duhet të pastrohen të gjitha detyrimet e prapambetura, që ministria, që qeveria, që parlamenti ta fillojnë vitin tjetër jo me një llogari detyrimesh të prapambetura; me sa pashë unë, 2, 9 miliardë shkonin për Unazën, loti 1, loti 2, Pallati me Shigjeta dhe pastaj pjesa tjetër e Unazës., ndërsa infrastruktura tjetër në Republikën e Shqipërisë pra s' merrte asgjë.

Kjo, zonja Ministre, ta kërkoj me shumë këmbëngulje dhe modesti, duhet të rishikohet, sepse qëllimi 1 nuk duhet të rrëzojë qëllimin 2. Qëllimi 1 dhe 2 nuk mund të rrëzojnë qëllimin superior: rritjen ekonomike. Konsolidimi fiskal nuk mund të rrëzojë

investimet publike, se duhet një balancë, dhe të dyja bashkë nuk mund të rrëzojnë rritjen ekonomike.

Nuk e di çfarë planifikimi keni, por ky është gjykimi juaj, por vitin tjetër do të duhet të dilet në treg me një eurobond të ri. Me eurobondin e ri, me detyrimet e prapambetura, sidomos në infrastrukturë, pastaj vjen TVSH dhe pushteti lokal. Është një histori, të cilën besoj se do ta trajtojmë më vete gjatë diskutimeve tona. Unë besoj se brenda këtij viti, Ministria e Infrastrukturës duhet t'i pastrojë komplet të gjitha detyrimet e prapambetura ndaj kontraktorëve, të gjitha detyrimet e prapambetura, të verifikuara.

Thamë se shpenzimet e përgjithshme të buxhetit kanë ato që përmendëm: 13, 3 miliardë, dhe këto shpenzime përbëjnë 29, 7 %, nga 29, 2 % që ishin një vit më parë. Ajo që bie në sy lidhur me shpenzimet buxhetore është rritja prej rreth 3 miliardë lekësh e investimeve publike ose 3, 7 pikë përqindje në krahasim me planin. Shpenzimet kapitale sot janë realizuar 92, 3 %, me një mosrealizim prej 6, 7 miliardë lekësh. Këto shpenzime përbëjnë 4, 7 % të prodhimit të brendshëm bruto, siç e theksova, nga 4, 8 % që ishte një vit më parë.

Shpenzimet korrente në vitin 2019 vlerësohet të jenë 21 miliardë lekë ose 4, 9 përqind më të larta se një vit më parë. Në krahasim me nivelin e planifikuar, këto shpenzime janë realizuar në masën 99, 3%, me një mosrealizim prej 3, 2 miliardë lekësh.

Karakteristikat kryesore të projektbuxhetit për vitin 2020 dhe periudhën afatmesme 2020 -2022. Thellimi i konsolidimit fiskal, tipari kryesor i buxhetit për vitin 2020 dhe për periudhën afatmesme 2020-2022, është vijimi dhe thellimi i mëtejshëm i konsolidimit fiskal. Kjo vërehet në parashikimin e treguesve të deficitit buxhetor dhe borxhit publik, si më poshtë:

Deficiti buxhetor parashikohet të jetë 1, 6 % e prodhimit të brendshëm bruto. në relacion keni përdorur fjalët korrekte: “më i ulëti i targetuar”, por është baras me 2018-ën si objektiv, që ishte 1, 6%. Jo i targetuar, por i realizuar. E thashë se jeni korrektë. Keni thënë: i targetuar më i ulëti në histori. Më i ulëti në histori, është fakti 1, 6 % i 2018-ës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni? Keni përdorur fjalën “targetim”. Fakti i 2018-ës është sa targetimi juaj i 2020-ës.

Faleminderit!

Fakti i 2020-ës me atë që shikoj unë në investimet publike, nuk duhet të jetë 1, 6, por kjo është diçka që i takon qeverisë dhe parlamentit, jo mua. Duhet të jetë 1, 9 për të shërbyer,

dhe prapë nuk do të arrish të shërbesh dot. Nuk është debat me mua, zoti Endrit. Kur i ke bërë debatet në ministri, besoj se ka fituar konsolidimi fiskal.

Deficiti buxhetor, siç e theksova, parashikohet të jetë 1, 6 % i prodhimit të brendshëm. Nga 1, 9 % i prodhimit të brendshëm, që është në vitin 2019, ose që pritet të jetë, gjatë periudhës afatmesme deficiti buxhetor parashikohet të reduktohet më tej, duke arritur nivelin 1, 1 % të prodhimit të brendshëm bruto, në 20-22. Për të pestin vit radhas, bilanci primar fiskal parashikohet të jetë pozitiv, 0, 8 % e prodhimit të brendshëm bruto, duke u rritur më tej vitet e ardhshme. Besoj se do të kalojmë në suficit një ditë, në 2023-shin, sipas llogarive që rezultojnë në trajektore.

Bilanci korrent fiskal parashikohet të jetë 3 %, duke arritur në 3, 5 % të prodhimit të brendshëm bruto në vitin 2022, jo duke rritur investimet publike, por duke ulur deficitin. Mund të ishin të dyja. Kjo tregon se të ardhurat e buxhetit financojnë shpenzimet korrente dhe një pjesë të shpenzimeve kapitale. Investimet parashikohen në nivelin 5, 5 % të prodhimit të brendshëm bruto. Nga këto, 3 % të prodhimit të brendshëm bruto financohen nga të ardhurat e buxhetit, ndërsa pjesa tjetër nga huatë. Ky zbatim i rregullit të artë të buxhetit tregon përgjegjshmëri në menaxhimin që u bëhet financave publike. Borxhi publik parashikohet të reduktohet gjatë periudhës afatmesme, duke zbatuar kështu një ndër rregullat kryesore fiskale të buxhetit dhe një ndër objektivat kryesorë të politikave makroekonomike për periudhën afatmesme.

Stoku i borxhit publik për vitin 2020 parashikohet të jetë 64, 4 % e prodhimit të brendshëm bruto, nga 65, 5 % e prodhimit të brendshëm bruto që vlerësohet të jetë në 2019-ën.

Besoj se një nga pyetjet e kolegëve ishte: cila është arsyeja që ngadalësohet konsolidimi? Gjithsesi, kur t'ju paraqiten pyetjet, do të keni kohë të përgjigjeni. Ndërkohë, ecurinë ndër vite dhe parashikimet për borxhin afatmesëm i kemi sipas tabelës që keni sjellë. Presupozohet që 2020-a të jetë 64, 4, 2019-a 65, 5, ndërsa 2021-shi 59, 8.

Objekt i rëndësishëm mbetet përmirësimi i vazhdueshëm i menaxhimit të borxhit. Për këtë qëllim huamarrja e brendshme do të synojë rritjen e përdorimit të titujve afatgjatë, duke përfituar edhe nga normat shumë të ulëta të interesit, shpresojmë në norma interesi fikse.

Huamarrja e huaj do të diversifikohet nëpërmjet burimeve të ndryshme, për të siguruar optimizimin e kostos së borxhit.

Do t'i lutem për qetësi medias, si dhe kujt qëndron pas Ministrisë së Financave, gjithë grupit të gazetarëve dhe asistentëve të ministrisë.

Vijimi i rritjes ekonomike me ritme pozitive të qëndrueshme. Një ndër objektivat kryesorë të projektbuxhetit është vijimi i rritjes ekonomike të vendit, e cila shoqërohet me rritjen e të ardhurave, punësimit, mbështetjes më të madhe të reformave, përmirësimit të shërbimeve ndaj qytetarëve, rritjes së mirëqenies së tyre, si dhe përshpejtimin të procesit të integritimit në Bashkimin Europian.

Rritja ekonomike në vitin 2020 parashikohet të jetë 4, 1 %. Gjithsesi, këtu ftova Ministrinë e Financave dhe ministren, që të reflektojnë edhe një herë nëse rritja e vitit 2019 do të jetë ajo që parashikoni, e pastaj parashikimi për 2020-ën është ky që keni paraqitur. Unë kam parë edhe tabelat që keni paraqitur. Ka një diferencë midis rritjes nominale që paraqet FMN-ja në Economic Outlook.

Do ta pyesja ministren, se cila është arsyeja që nominalen e 2020-ës e keni më pak se nominalja që nxjerr Fondi Monetar Ndërkombëtar. Mund ta kishit më pak, mund ta kishit më shumë, por unë thjesht dua të di arsyen. Cila është arsyeja që e keni planifikuar më pak nominalen e vitit 2020?

Rritja ekonomike do të mbështetet nga rritja e kërkesës së brendshme nëpërmjet rritjes së konsumit dhe të investimeve. Kontribut pozitiv pritet të japë... dhe këtu do t'i kërkoja Ministrisë së Financave edhe rritjen e totalit të investimeve, sidomos të investimeve private, në raport me prodhimin e brendshëm bruto, ka qenë 21 %, për të parë trajektoren dhe planifikimin në vite, për të furnizuar rritjen ekonomike, siç referoheni edhe në relacion; kontributin e aktorit qeveri në investimet publike. Këtu do të kërkoja të dija se cilat janë investimet publike që mbarojnë në vitin 2021. Nëse për shkak të konsolidimit fiskal apo për arsye të tjera ka **outcrowding**, pra shtyrje të limiteve të investimeve, gjë për të cilën, në njërin anë departamenti i buxhetit nuk do t'ia dijë, por në anë tjetër, departamenti i makros, dhe sidomos ministrja, është më e interesuar për rritjen ekonomike, të furnizuar nga faktorë cilësorë dhe të ekuilibruar mirë, siç janë investimet publike, investimet private, uljen e borxhit nëpërmjet uljes së deficitit, por e gjithë kjo në kuadër e në funksion të rritjes ekonomike, dhe jo në kuadër dhe në funksion të një shifre të deficitit.

Rritja e të ardhurave të përgjithshme të buxhetit të shtetit. Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit për vitin 2020 parashikohet të rriten me 29, 3 miliardë lekë ose 6, 2 % në krahasim me vitin 2019. Ato përbëjnë 28 % të prodhimit të brendshëm bruto, duke u rritur me 0, 2 % nga 2019-a.

Ajo që unë shoh këtu si rritje, është kryesisht nga ndihmat. 0, 2 % i bie nga të ardhurat prej tatimeve dhe doganave, ku një pjesë të konsiderueshme e kapin të ardhurat nga pushteti lokal dhe nuk shoh arsyen, por besoj sedo të diskutohet kur të kemi seancën e përgjigjeve të

pyetjeve, se cila është arsyeja që të ardhurat bien në përqindje të prodhimit të brendshëm bruto të sigurimeve shoqërore. Ndërkohë që ne planifikojmë rritje të pjesëmarrjes në forcën e punës, ulje të papunësisë dhe rritje të pagës mesatare reale dhe ndoshta në një moment tjetër edhe të asaj minimale. Ka një kundërshti midis rritjes së të ardhurave nga sigurimet shoqërore me atë që planifikojmë në punësim dhe në zhvillimin ekonomik. Gjithsesi këto janë pyetje që do t'i diskutojmë një nga një nesër, sepse nga ana procedurale ajo që do të bëjmë sot është relatimi i buxhetit nga ministria, nga relatori dhe relatimi i paketës fiskale nga ministria dhe nga relatori zoti Angjeli. Do të bëjmë 5 minuta pushim për të grumbulluar pyetjet.

Zonja Ministre, të gjitha pyetjet do t'ju dorëzohen, do të keni kohë gjatë gjithë ditës sot, se janë gati 100 e ca pyetje. Nesër besoj do të kemi seancën për t'u përgjigjur këtyre pyetjeve në mënyrë që të keni edhe ju racionalitetin tuaj kohor për t'u përgatitur. Këto kundërshti që i përmendëm janë shumë të rëndësishme për t'u përputhur. Imagjinoni: bie në prodhimin e brendshëm bruto e ardhura nga sigurimet shoqërore, ndërkohë që pjesëmarrja në forcat e punës planifikohet e rritur, punësimi planifikohet i rritur, paga mesatare planifikohet e rritur, paga reale planifikohet e rritur, paga minimale planifikohet e rritur dhe hajdeni t'i bashkoni! Janë elemente që do t'i diskutojmë një nga një.

Këtu dua me modesti t'ju tërheq vëmendjen për disa elementë planifikimi, ndërkohë që të ardhurat tatimore nga tatimet dhe nga doganat në traditë shkojnë në rritje rreth 4,2- 6. Viti 2019 e ka rritjen 3,1 nga tatimet dhe doganat, ndërkohë që keni planifikuar 6,4%. Pra, do t'i kërkoja ministres dhe departamentit të na argumentoni, për shembull tek tatimfitimi nëse këtë vit është rritur vetëm 2%, vitin tjetër rritet 8,4%. Do të rritet profitabiliteti? Nuk ka paguar OSHE-në, sa për qind ka OSHE-ja, sa është rritur pjesa tjetër? A e justifikon rritjen për vitin tjetër pjesa tjetër?

Kam bërë një kërkesë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimtaksave dhe për dijeni Ministrisë së Financave për profitabilitetin e vitit 2019 dhe planifikimin e tij të kompanive duke kalkuluar veç kompanitë shtetërore, veç i gjithë sektori privat për të gjykuar me profesionalizëm dhe me përgjegjshmëri politike për atë që na pret.

Rritja e shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit dhe përmirësimi i cilësisë së tyre.

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit për vitin 2020 parashikohen që të rriten me 25,7 miliardë ose 5,1 %, në krahasim me vitin 2019. Në raport me prodhimin e brendshëm bruto, shpenzimet e përgjithshme mbeten në të njëjtin nivel me 29,7%, rritja e shpenzimeve të përgjithshme parashikohet të arrihet si në shpenzimet korente ashtu edhe në ato kapitale,

por te kapitalet nuk më rezulton e vërtetë. Planifikoni në mos gaboj, më korrigjoni 83, 7 miliardë që është më pak se viti 2018.

Besoj se komisioni, të paktën pjesa e pozitës ka ndaluar në diskutimet që kemi bërë tek investimet. Kërkoj një argumentim serioz se cila është arsyeja që investimet publike planifikohen në rënie dhe nominalisht. Ndërkohë që kemi detyrime të prapambetura, por gjatë pyetje- përgjigjeve mund t'u referoheni edhe shifrave. Edhe ndonjë gabimi që mund të bëjë unë apo kolegët deputetë, na korrigjoni ose na argumentoni se cila është arsyeja që nga 87 në vitin 2018, pavarësisht mosrealizimit, planifikohet në 83 vitin tjetër. Në raport me prodhimin e brendshëm bruto, cila është arsyeja që investimet publike do të vazhdojnë të planifikohen në reduktim, ndërkohë që nevoja për investime publike në infrastrukturë, në shëndetësi, në arsim vjen gjithmonë duke u rritur, sidomos e ripërsëris konektiviteti, ndërkohë që Kryeministri, qeveria planifikojnë edhe zgjerimin e zonës së lirë ekonomike të Ballkanit Perëndimor? Besoj se ju e dini po kaq mirë sesa unë që nuk mund të ketë dot zgjerim efikas vetëm me heqjen e tarifave. Ne i kemi hequr tarifat nëpërmjet CEFTA-s pa konektivitet.

Për sa u përket shpenzimeve korrente parashikohet të rriten me 21 miliardë lekë ose 4,9%. Unë kam bërë një kërkesë dhe do t'ju vijë me shkrim se cilat janë politikat e reja që do të financojë buxheti i shtetit, a ka ndonjë politikë të re sociale rishtas në vitin 2020? Në leximin tim të relacionit, e pranoj që mund të jem edhe gabim nuk ka asnjë politikë të re sociale apo një politikë të re mbështetëse për pjesën e shpenzimeve. Nuk planifikohet për sa arrita të kap nga shifra dhe harxhova shumë kohë, por më korrigjoni, nuk shikoj rritje të pagave për vitin tjetër. Pashë se ka një indeksim të pensioneve, në mos gaboj si shifër, nëse e mbaj mend mirë 2,52 miliardë lekë. Jam korrekt? Dhe një shifër rreth 2 miliardë lekë vazhdimi i financimit të bonusit të bebeve. Nuk ka planifikim sërish bonus për pensionistët dhe siç e theksova nuk ka asnjë politikë të re në atë që lexova, por besoj se ju do të më korrigjoni, e cila të fillojë rishtazi në vitin 2020.

Për sa i përket rritjes së investimeve publike, siç e theksova gjatë vitit 2020 parashikohen të realizohen objekte të rëndësishme të infrastrukturës rrugore: Rruga e Arbrit, rruga Milot -Balldren. Nuk financohet nga buxheti i shtetit në vitin 2010, asnjë lekë, zonja drejtoreshë, pra mos e përmendni rrugën Milot-Balldre, pasi financohet në vitin 2021.

Orikum-Dukat, a jeni të bindur që do të fillojë të punojë dhe keni planifikuar aq pak para, nëse ai do të bëjë 25% të punës në bazë të kontratës së koncesionit. Ju keni planifikuar vetëm 300 milionë lekë: ose planifikohet 25%-shi i punimeve dhe transhi i parë

i pagesës ose nuk planifikohet fare, duke iu referuar punimeve fizike, për të qenë korrekt, sepse këto krijojnë detyrime të prapambetura, të cilat i kanë në kurriz ministrja, Kryeministri dhe parlamenti.

Për sa më takon mua, nuk ka asnjë rrugë të re që të hapet nga investimet publike, por më rezulton se është shtyrë një pjesë e punëve nga viti 2021 në vitin 2022 si: Kardhiq – Delvinë, Elbasan-Banjë, keni vetëm 78 mijë lekë për të paguar. Paguajeni dreqi e mori dhe hiqeni nga lista e investimeve publike, sepse u bënë 8 vjet! Baipasi i Shkodrës, hiqeni 52 milionë lekë që keni vënë në buxhet! Paguajeni komplet, nxirreni nga lista. Baipasi i Tepelenës që keni parashikuar vetëm 300 milionë lekë, nuk është normale, ndërkohë është shumë i rëndësishëm në aspektin e konektivitetit, sepse bashkon Sarandën me Delvinë-Kardhiq, baipas i Fierit- Tiranë. Është aks konektiviteti dhe nuk mund të financohet 300 milionë lekë, ndërkohë që kushton pa TVSH, në mos gaboj 2,2 miliardë lekë. Është paguar në referencë të asaj që bisedova me ministren e Infrastrukturës dje, diku te 400 milionë lekë. Këto janë elemente shumë të rëndësishme të konektivitetit dhe duhet që të ngrihen sipër për t’u financuar.

Zonja Ministre, dua një plan konkret, konsultohu me ministren e Infrastrukturës, se për sa vjet do të përfundojë Unaza e Tiranës? Financoni lote të ndryshme në mos gaboj 2,8 miliardë: loti parë, loti i dytë rreth 890, “Pallati me shigjeta” rreth 900 milionë dhe diçka rreth 1 miliard një nga projektet e tjera të unazës që shkojnë 2,8 miliardë. Dua në emër të komisionit një plan kur mbaron unaza, si financohet afatmesëm, afatgjatë? Siç kemi në Ministrinë e Financave planin e financimit të PPP-ve dhe të koncesioneve për 13 vjet, nuk kemi pse të mos e kemi, e duam. Unë e kam thirrur edhe ministren në komision. Kur mbarojnë rrugët? Historia që rrugët shtyhen se nuk ka para, duhet të rishikohet. Unë jam i bindur se Kryeministri është më i interesuar se kushdo tjetër që ato premtime përpara qytetarëve për konektivitetin të mbarojnë në kohën e duhur, për sa më përket mua si përfaqësues i maxhorancës brenda vitit 2021, sepse ne kemi edhe qëllime të konsolidimit fiskal, të rritjes ekonomike, por ne të pozitës u referohemi edhe objektivave tona elektorale, që janë objektiva të përputhur me rritjen e mirëqenies së qytetarëve dhe të rritjes ekonomike.

Mbështetja e buxhetit për mbrojtjen, gjatë vitit 2020. Projektbuxheti për Ministrinë e Mbrojtjes parashikohet të rritet me 2,8 miliardë lekë në krahasim me vitin 2019. Kjo rritje synon realizimin e objektivit të ndërmarrë në kuadër të anëtarësimit të vendit në NATO, që buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes të jetë 2% të prodhimit të brendshëm në vitin 2022.

Mbështetja e reformës në drejtësi. Projektbuxheti plotëson të gjitha nevojat financiare të institucioneve të reja të krijuara në kuadër të reformës në sistemin e drejtësisë. Një nga pyetjet është: detajimi i të gjithë mbështetjes. Besoj se e keni shumë të thjeshtë që nesër të na e paraqisni atë detajim.

Gjithashtu për KLP-në, KLGJ-në, Byroja e Hetimit dhe SPAK-u, projektbuxheti siguron mbështetje financiare për pagat e rritura të magistratëve dhe oficerëve të Policisë Gjyqësore. Ka pasur një diskutim parë 7 muajsh për sa i përket hierarkisë së pagave.

Zonja Ministre qëndrimi im pavarësisht se ju ndoshta nuk më kuptuat atë ditë ishte se Ministria e Financave duhet të ketë fjalën e fundit në përcaktimin e hierarkisë së pagave dhe jo hierarkia e pagave të vendoset nëpërmjet vullneteve politike. Këto të fundit duhet të konvergojnë të konsolidimi fiskal. Nuk po them se duhet ta sillni brenda këtij muaji, por do t'ju lutesha të ndërmerrni një iniciativë brenda qeverisë për rishikimin e piramidës së pagave dhe të gjitha në funksion të konsolidimit fiskal, të të gjitha përgjegjshmërive që kanë institucionet të përputhen dhe të vetohen nga Ministria e Financave, ndryshe të jeni e bindur se në një periudhë prej pesë vjetësh nuk do ta marrë më vesh i pari të dytin se kush i vendos pagat, sa dhe për kë në Republikën Popullore të Shqipërisë në sektorin publik. Kështu që do t'ju lutesha që ta bëni një iniciativë brenda qeverisë. Besoj se do t'ju mbështesë Kryeministri, pasi ka të njëjtin shqetësim që unë e përqsas sot me ju.

Konsolidimi i procesit të menaxhimit financiar në nivel vendor dhe mbështetja e reformës administrativo-territoriale dhe decentralizimit fiskal të pushtetit vendor janë dy objektiva të tjerë të rëndësishëm të projektbuxhetit. Shpenzimet për pushtetin vendor parashikohen të rriten me 3,3 miliardë ose 6,2% pikë përqindje, në krahasim me vitin 2019. Kjo rritje do të sigurohet si nga rritja e transfertës së pakushtëzuar për pushtetin vendor, ashtu edhe nga rritja e të ardhurave të tij.

Gjatë vitit 2020 do të vazhdojë mbështetja financiare për reformën në arsimin parashkollor, në atë përmirësim... Numri 18 për edukatore zbret në 15... Jam korrekt, zonja Dhëmbi, me shifrat?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, nga 18 zbretet në 15, pra për të vendosur një skemë financimi të përshtatshme dhe efektive, që synon përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.

Përpara se ta mbyll fjalën time: të ardhurat në projektbuxhetin e vitit 2020 parashikohet të rriten me 0,2% të prodhimit të brendshëm bruto. Unë e përmenda në fjalën time që një pjesë e tyre ose e gjitha vjen nga rritja e ndihmave, nga 0,8% e prodhimit të brendshëm bruto, në 0,9% e prodhimit të brendshëm bruto, që në vitin 2018 ka qenë 0,5% e

prodhimit të brendshëm bruto. Pastaj, nga të ardhurat e pushtetit vendor, si dhe nga të ardhurat e fondeve speciale, unë mendoj se rritja e të ardhurave duhet të shihet edhe një herë (janë mendimet e mia) me ju, sepse ka vende ku rritja duhet të jetë më e lartë, ka vende ku rritja duhet të jetë më modeste. Por besoj që gjatë diskutimit që do të bëjmë së bashku për të ardhurat, do të kemi mundësi të përfaqësojmë me njëri-tjetrin dhe aty ku do të biem dakord, të reflektojmë, ndërsa aty ku nuk do të biem dakord, unë jam i bindur se ju do të sillni argumente të parrëzueshme nga ana jonë për qëndrimet tuaja.

Por më duhet të them se një nivel i tillë i të ardhurave kufizon financimin e investimeve publike dhe të shpenzimeve të tjera të nevojshme për kryerjen e reformave dhe funksionimin e institucioneve publike.

Për sa i takon mbështetjes për energjinë, keni vendosur 2,5 miliardë, ndërkohë që unë do të desha një argumentim nga ju se cila është arsyeja që mbështetja është 2,5 miliardë, ndërkohë që, të paktën kërkesat nga çfarë i jam referuar unë, dhe jam i bindur se ky tavan në vitin 2020 do të thyhet, pra kur të sillni aktin normativ, do të prekni tavanin prej 2,5, të paktën prej 3,5...

Mirë është që, meqenëse jemi në një diskutim kaq racional të buxhetit me njëri-tjetrin, ndoshta-ndoshta ia vlen ta reflektojmë që tani. Ky është një mendim nga ana ime dhe nëse do të biem dakord, mund ta bëjmë; nëse nuk do të biem dakord, në respekt të ministres dhe të Ministrisë së Financave, nuk do ta vetoja për ta rritur, por do t'ju dëgjoja argumentin. Jam i bindur se ai 2,5 miliardë do të preket, sado ju keni gjykimin tuaj, gjithsesi...

Besoj se niveli i të ardhurave nuk siguron mbështetjen e nevojshme për konsolidim të shpejtë dhe të thellë fiskal. Për këtë arsye, mendoj që përfaqësuesit e Ministrisë së Financave duhet ta informojnë komisionin lidhur me efektin e pritshëm të reformës së fiskalizimit dhe të përmirësimit të administrimit tatimor (sa është ndikimi i këtij faktori në rritjen e të ardhurave vjetore). Besoj se zoti Angjeli do t'u referohet në detaje këtyre elementeve.

Në relacion...

Zonjë, keni edhe datëlindjen sot, por...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk ka gjë, mos kërkonit të falur, por vetëm mos bezdisni edhe nënkryetarin e Kuvendit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në relacionin e projektligjit theksohet që për periudhën nëntëmuajore të vitit 2019 ka pasur një mungesë të të ardhurave prej 2% në krahasim me planin. Kjo mungesë e të ardhurave është absorbuar plotësisht brenda hapësirave të amortizuara të krijuara që në

buxhetin fillestar. Kjo do të thotë që buxheti fillestar i vitit 2019 është parashikuar i fryrë. E kam dëgjuar disa herë këtë argument edhe nga drejtorët e tatimeve (të pestë), që kanë qenë këtë vit (dy të tatimeve, tre të doganave): plani, plani, plani, plani.

Në relacion, do t'jua lexoj në një moment të dytë, metodologjia është e njëjtë, pra ajo që kemi parashikuar në vitin 2019 është e njëjtë me atë që kemi parashikuar në vitin 2020. A është e vërtetë, zoti Niko?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit!

Në fakt, kur u hartua buxheti fillestar i vitit 2019, u theksua se parashikimi i të ardhurave ishte realist, madje unë kam thënë në këtë komision, por në një pozicion tjetër, se të ardhurat nga dividendi do të jenë në vlerën 7 miliardë.

Drejtori këmbëngulte që do të ishin në vlerën 4 miliardë, por ato e tejkaluan drejtorin, më tejkaluan edhe mua, dhe shkuan në vlerën 8 miliardë, afërsisht plus. Pra, që ka qenë parashikim i fryrë, për këtë do t'ju lutesha, në respekt të këtij komisioni, të mos i lejoni drejtorët t'ia thonë Kryeministrit kur i referojnë për të ardhurat.

Gjithashtu, prej vitesh parashikimi i fryrë i të ardhurave është konsideruar nga KLSH-ja dhe nga Kuvendi një fenomen negativ që ndikon në reduktimin e efektivitetit të fondeve publike. Prandaj, mendoj se përfaqësuesit e Ministrisë së Financave duhet ta argumentojnë, pra të na japin informacion (është njëra nga pyetjet këtu).

Niveli i shpenzimeve publike për vitin 2020 parashikohet të jetë i njëjtë me atë të vitit 2019 prej 29,7% të prodhimit të brendshëm bruto, ndërkohë që në vitet 2021 dhe 2022 parashikohet që niveli i shpenzimeve publike të reduktohet, duke arritur respektivisht në vlerat 29,1 dhe 28,9, ku kategoritë dhe zërat që preken janë: personeli, në raport me prodhimin e brendshëm bruto, nga 4,8 në 4,7, në 4,6 dhe në 4,5, gjë që nuk do ta pranojmë, dhe niveli i investimeve publike nga 4,8 në 4,7, në 4,6.

Konsolidim fiskal, në kurriz të punonjësve të administratës të njerëzve në nevojë dhe të investimeve publike, nuk ka. Prandaj i kërkoj qeverisë të reflektojë për vitin tjetër dhe për vitet e ardhshme, ku të mendojë për njerëzit në nevojë: me paketa sociale, me bonus pensionistësh, me rritje pagash dhe me rritje investimesh. Ne jemi parti e majtë, që drejtojmë vendin, dhe do të avancojmë me politika në mbështetje të qytetarëve në nevojë, si dhe për pensionistët, ata me paga më të ulëta, me investime publike për infrastrukturën, konjektivitetin, shëndetësinë dhe arsimin. Prandaj komisioni (pjesa e pozitës në rastin konkret), ndjesë për pjesën e opozitës, sepse besoj që ju do të keni qëndrimin tuaj, nuk e pranon këtë lloj konsolidimi fiskal.

Nuk mund të ketë konsolidim fiskal kur bëhen vrima në taksa dhe, pastaj, për shkak të vrimave në taksa, asaj që ma sillni edhe *tax expenditure*... Ju lutem, hiqeni nga relacioni atë që keni konfuzuar Republikën e Shqipërisë...

Tax expenditure në teknikalitet është kur devijohet nga *rate*-i standard. Ndërsa në të ardhurat personale, *rate*-i standard, nga 300 000 lekë të vjetër deri në 150, është 13, jo 15! Nuk mund të konsiderohet *tax expenditure*! Ju lutem, ma hiqni nga relacioni, pasi keni konfuzuar të gjithë Republikën e Shqipërisë, mua po e po, sepse, kur e lexova, mendova që është bërë lapsus (patjetër që po), teknikisht nuk qëndron, nuk është *tax expenditure* dhe nuk prezantohet ashtu në relacion!

Por, në emër të komisionit, dua t'ju them që qeveria duhet të sjellë paketa lehtësuese, të rëndësishme për qytetarët në nevojë, rritje pagash për pagat e ulëta dhe ato të larta, si dhe rritje të investimeve publike. Nuk mund ta pranojmë që konsolidimi fiskal do të vijë në kurriz të qytetarëve në nevojë dhe të nevojës së madhe për investime publike.

Si rezultat i rritjes mjaft të ulët të të ardhurave dhe mosrritjes së shpenzimeve, deficitit buxhetor në vitin 2020 ka një rënie të lehtë, nga 1,9% në vitin 2019, në 1,6% në vitin 2020. Planifikimi i një niveli të tillë të deficitit buxhetor duket se nuk siguron mbështetjen e duhur për konsolidim fiskal, duke u kombinuar me elementet që unë përmenda më parë.

Deficiti nuk qëndron më vete, nuk është një figurë, nuk është një e dhënë *stand alone*, por është konsekuencë e politikave fiskale, e politikave buxhetore dhe e përgjegjshmërisë në menaxhim.

Shpenzimet, sipas funksioneve, për vitet 2019 dhe 2020 janë si më poshtë: “Në përqindje të prodhimit të brendshëm bruto, shërbimet e përgjithshme publike nga 2,3% e prodhimit të brendshëm bruto zbresin në 2,2% të prodhimit të brendshëm bruto; mbrojtja nga 0,8% shkon në 0,9%; rendi dhe siguria publike, ndërkohë që Kryeministri ka ndërmarrë aksionin më të madh antikrim në historinë e Shqipërisë, qëndrojnë në 1,7%; çështjet ekonomike zbresin nga 2,6% e prodhimit të brendshëm bruto (si funksion) në 2,35; mbrojtja e mjedisit ngelet modeste në 0,1%; strehimi dhe komoditetet e komunitetit nga 1,8% e prodhimit të brendshëm bruto zbresin në 1,6%; shëndetësia, që është prioritet, ngelet në 3%; argëtimi dhe kultura ngelen në 0,2%; arsimi ngelet në 2,5%; mbrojtja sociale nga 9,2% zbret në 9,1% të prodhimit të brendshëm bruto”.

Lidhur me shpenzimet e tjera të pakualifikuara, nuk dua ta konfuzoj audiencën, zbresin nga 6,3% në 6%.

Nga tabela vërehet se shpenzimet, sipas funksioneve të qeverisjes, për buxhetin e vitit 2020, në përgjithësi, janë në nivelet e buxhetit të vitit 2019, por një pjesë e mirë e tyre që

reflektojnë edhe prioritetet e qeverisë apo të maxhorancës reflektojnë rënie. Pra, mendoj se projektbuxheti duhet t'i mbështesë shumë më shumë prioritetet në arsim, në shëndetësi dhe në sektorët e tjerë të ekonomisë. Për këtë çështje mendoj se do të kemi një diskutim goxha të gjatë kur të prezantohet buxheti.

Në përfundim, mbështetur në argumentet e mësipërme, i sugjeroj komisionit një debat, një diskutim të thellë dhe të gjatë, në respekt të përgjegjshmërisë së Ministrisë së Financave, por edhe në respekt të prioriteteve të qeverisë, të Kryeministrit dhe të maxhorancës për të reflektuar në furnizimin me financim të atyre elementeve që unë përmenda më lart.

Faleminderit!

Besoj të kalojmë si procedurë në pikën e dytë të paketës fiskale.

Fjalën do t'ia jap fillimisht ministres dhe pastaj relatorit. Do të bëjmë pesë minuta pushim, do të mbledhim pyetjet dhe do të fillojmë me nga një pyetje secili. Pastaj të gjitha pyetjet e tjera t'ia dorëzojmë ministres...

I lutem sekretarisë të mbajë shënim në mënyrë të detajuar të gjitha pyetjet, në mënyrë që ministrja dhe stafi i saj të kenë kohë t'u përgjigjen. Aty ta mbyllim me pyetjet tona dhe ministrja të vijë nesër, së bashku me stafin, për t'u përgjigjur.

Biem dakord, zonja Ministre?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Dakord.

Për procedurë?

Artur Roshi – Po, për procedurë.

Unë do të doja që komisioni të na vinte në dispozicion edhe buxhetin faktik të vitit 2019 për të pasur disa tabela krahasuese.

Arben Ahmetaj – Pra, doni buxhetin e vitit 2019?

Artur Roshi – Po, sepse nuk kemi kujt t'i referohemi, nuk kemi infrastrukturë, dhe përderisa kjo infrastrukturë ekziston te komisioni, nuk ka pse të mos e përdorim.

Arben Ahmetaj – Patjetër.

Artur Roshi – Jo vetëm për këtë, por marr shkas për të gjitha projektligjet që ndryshojnë në parim.

Arben Ahmetaj – Të pritshmin e vitit 2019 e ka dërguar ministria, në mos gabohem. Kam kërkuar edhe buxhetin fillestar, domethënë ligjin e buxhetit të vitit 2019 që ka kaluar në dhjetor të 2018-ës.

(Diskutim pa mikrofon)

Artur Roshi – E mira është të jemi seriozë për çdo gjë. Unë flas në parim për çdo projektligj. Për një projektligj duhet të dimë si ka qenë dhe çfarë ndryshohet, pra të kemi tabela krahasuese. Quhet marrje informacioni e kollajtë dhe e shpejtë, duke qenë që është infrastruktura, sepse ne që jemi deputetë jashtë grupeve parlamentare, nuk kemi infrastrukturë për të mbledhur informacion dhe është punë shumë e madhe, duke pasur parasysh që ne e marrim informacionin vetëm një ditë para. Këto i them që të vijmë seriozë dhe të përgatitur në komision. Kjo është logjika.

Arben Ahmetaj – Është e saktë ajo që thoni. Më lejoni të them së Ministria e Financave ka qenë shumë e përgjegjshme në dërgimin e informacionit, pra ka një traditë të konsoliduar dhe aspak ndryshe edhe këtë vit që informacioni ka ardhur i detajuar. Megjithatë është detyra e sekretarisë dhe nëse do të ketë ndonjë mungesë dokumentacioni, do t’ua kërkojmë që t’jua vëmë në dispozicion.

Ju lutem, zonja Ministre, filloni me prezantimin e paketës, pastaj të lejojmë zotin Angjeli që të bëjë relatimin e paketës.

Po, zonja ministre, fjala është për ju.

Anila Denaj – Shumë faleminderit, zoti kryetar!

Te nderuar deputetë,

Në projektligjin e paketës fiskale 2020 kemi sjellë në vëmendje të të gjithë anëtarëve nevojën për t’u thelluar te ndryshimet në legjislacionin fiskal, si një nga kapilarët kryesor të këtij prezantimi, i cili prek në thelb disa elemente në 4 ligje, kryesisht ligjin nr. 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat”, ligjin nr. 9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”, ligjin nr. 9975 “Për taksat kombëtare”, ligji nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”.

Konkretisht këto ndryshime në këto projektligje konsiderohen të sjellin këto elemente: për projektligjin nr. 8438, datë 24.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”” synon trajtimin tatimor për tatimin e të ardhurave nga punësimi në të njëjtën mënyrë për të gjithë individët, të cilët kanë të ardhura nga paga nga më shumë se një burim. Këta individë do të kenë detyrimin të dorëzojnë një deklaratë individuale vjetore të të ardhurave edhe nëse realizimi i të ardhurave vjetore është më i vogël se 2 milionë lekë.

Së dyti, është incentivimi i sektorit të industrisë automobil automotive, duke caktuar normë tatim-fitimi me 5 %, njësoj si në sektorë të tjerë të rëndësishëm për të zgjeruar bazën e punësimit, ku personat juridikë që ushtrojnë veprimtari juridike në këtë industri, do të përfitojnë njësoj 5%

Arben Ahmetaj – Zonja Ministre, më falni që po ju ndërpres, por kam një pyetje! Më konfirmojnë nga Kabineti i Kryeministrit që ka mbledhje qeverie dhe ju jeni atje. A doni të ikni?

Anila Denaj – E kam deleguar te zëvendësministri.

Arben Ahmetaj – Dakord, sepse më erdhi një SMS dhe e pashë tani.

Meqë keni deleguar zëvendësministrin, atëherë është në rregull.

Anila Denaj – Unë e kam të deleguar, megjithatë e sqarojmë.

Do të doja ta mbaroja këtë prezantim.

Arben Ahmetaj – Mund ta ndërpresim dhe të presim kur ju të ktheheni nga mbledhja. Nuk ka problem. Gjykojeni vetë! Nëse ju konfirmojnë që është deleguar, vazhdoni!

Anila Denaj – Deri në marrjen e një konfirmimi unë po vijoj. Ju faleminderit për fleksibilitetin!

Pra, pika e dytë është incentivimi i sektorit të industrisë automotive, duke e caktuar normën e fitimit nga 5% në 15%. Çfarë pritshmërie kemi këtu? Është zgjerimi i numrit të ndërmarrjeve që, kryesisht me investime të huaja, mund të sjellin një rritje më të lartë punësimi, duke krijuar edhe një shpërndarje gjeografike të këtij punësimi në të ardhmen.

Së treti, promovimin e sportit me qëllim rritjen e impaktit pozitiv në shoqëri për personat juridikë, të cilët realizojnë fitim vjetor të tatueshëm mbi 100 milionë lekë. Shumat e sponsorizuara në fushën e sportit, të njohura si shpenzime të zbritshme, për efekt të llogaritjes së tatimit mbi fitimin, janë të zbritshme sa trefishi i shumës së sponsorizuar. Gjithashtu shpenzimet e njohura të sponsorizimit për sportin rriten nga 3% në 5%.

Së katërti, mbartja e humbjes për një periudhë 5 –vjeçare, për tatimpaguesit që investojnë në projekte biznesi me vlerë mbi 1 miliardë lekë. Më lejoni t’ju kujtoj se kjo mbartje e humbjes aktualisht është për një periudhë 3-vjeçare. Konsiderojmë se për investime mbi 1 miliardë lekë nevoja e mbartjes së humbjes për një afat 5-vjeçar, është jo vetëm një standard i njohur, por edhe një nevojë e shumë bizneseve në Shqipëri.

Së pesti, harmonizimi i ligjit nr. 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar” për ligjin “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, që shpresoj të jetë duke u aprovuar në mbledhjen e qeverisë, që po zhvillohet.

Projektligji i dytë, i cili prek disa elemente është për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” propozon këto ndryshime: harmonizimin e dispozitave përkatëse të ligjit “Për procedurat tatimore” me përcaktimet e projektligjit “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i cili sjell një risi në procesin e faturimit dhe monitorimit të transaksioneve, harmonizimin dhe unifikimin e kundërvajtjeve administrative, që lidhen më çështjen e faturimit, duke synuar përshkallëzimin e gjobave sipas përgjegjshmërisë tatimore.

Më lejoni të theksoj që në objektivin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nuk është rritja e të ardhurave nëpërmjet të gjobave dhe këtë e kemi theksuar disa herë, se lufta ndaj informalitetit nuk bëhet duke vendosur gjoba, megjithatë gjykojmë që elementi gjobë është i rëndësishëm të jetë i përshkallëzuar, sipas madhësisë së biznesit dhe frekuencës së gjetjes në shkelje të ligjit. Për këtë arsye tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësinë tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, të cilët nuk janë të regjistruar për TVSH-në dhe tatimpagues të tjerë, dënohen me gjobë prej 50 mijë lekësh. Tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësi tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël dhe për TVSH -në, dënohen me gjobë prej 100 mijë lekësh, tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësinë tatimore të tatimit mbi fitimin dhe për TVSH-në, dënohen me një gjobë prej 150 mijë lekësh. Pra, kemi një përshkallëzim për biznesin e vogël pa TVSH, me TVSH dhe për biznesin e madh, nga 50, 100 dhe 150 mijë lekë.

Kjo është e nevojshme për të qenë më korrekt edhe në zbatim të gjetjeve në shkelje të ligjit.

Synohet kompensimi i detyrimeve tatimore ndërmjet administratës tatimore dhe asaj doganore, sipas procedurave të përcaktuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për Financat, lidhja e një marrëveshjeje për detyrimet që administrata tatimore ka ndaj tatimpaguesve për TVSH-në e rimbursueshme sipas një plani pagese të rënë dakord. Ky parashikim do të zbatohet deri në datën 30.06.2021, një afat ku të gjitha këto detyrime mendohet të zërohen, zgjerimi i objektit për lidhjen e marrëveshjes së pagesës me këste për detyrimet e tatimpaguesve dhe për detyrimet e vetëdeklaruar për TVSH, si dhe për sigurimet shoqërore në rastet specifike për institucionet buxhetore.

Më lejoni të theksoj që të gjitha këto elemente janë pjesë e një VKM-je për të përcaktuar procedurat mbi të cilat do të bazohen këto vendimmarrje. Ndryshimi i deklaratës së tatimpaguesit, bëhet vetëm një herë brenda 36 muajve dhe për sigurimet shoqërore vetëm një herë në muajin pasardhës. Njoftimi i tatimpaguesit para kontrollit dhe vizitës fiskale nga 30 ditë do të ulet nga 10 deri në 5 ditë respektivisht.

Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”” synon përjashtimin nga TVSH-ja i automjeteve të reja vetëm me motor elektrik, harmonizimin e dispozitave përkatëse të ligjit “Për tatimin mbi vlerën e shtuar të Republikës së Shqipërisë” lidhur me faturimin, me përcaktimet e projektligjit “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimi”, i cili sjell një risi në procesin faturimit dhe të monitorimit të transaksioneve.

Së katërti, projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9974, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”” synon saktësime të nevojshme që kanë ardhur si pasojë e zbatimit në praktikë të ligjit lidhur me aplikimin e dispozitave në raport me aplikimin e taksave për automjetet e luksit, ndryshimin e përcaktimeve të vlerës së mjetit për efekt të kriterëve, që duhet të përmbushë një automjet për t’u konsideruar automjet luksi, duke u [martizuar](#) në vlerën e mitit me 10% deri me vlerë të mbetur, ndryshime në penaltet për qëllim unifikimin e gjobës për pagesë të vonuar për taksën vjetore të mjeteve të përdorura me gjobat e aplikuara sipas ligjit “Për procedurat tatimore”, shtimin e kategorisë së personave me aftësi të kufizuar për t’i përjashtuar nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura, përjashtimin nga pagimi i taksës vjetore të mjeteve të përdorura, automjeteve të hershme me interes historik dhe koleksionimi, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Në vijim më lejoni të theksoj se kjo paketë fiskale nuk është një paketë tipike, e cila do të ketë ndryshime në përlllogaritjen e të ardhurave. Ne gjykojmë që ndryshimet administrative të përmendura pak më lart, jo vetëm për të krijuar një bazë të mirë për të përcaktuar platformën e aplikimit më të mirë të rregullave për ligjin e ri të fiskalizimit, që pritet të vijë për diskutim në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave dhe në komisionet e tjera, por mbi të gjitha për të sistemuar disa elemente të miradministrit të gjetura këtë vit si një nevojë e domosdoshme gjatë procesit të luftës ndaj informalitetit. Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Zonja Ministre, ju thatë që do t’i kuantifikoni në të ardhmen përmirësimet administrative në bazë të ligjit të fiskalizimit? Apo e kuptova gabim?

Anila Denaj – Jo nuk përmenda këtë, unë thashë që kuadri ligjor vjen në qasje të harmonizimit të kuadrit ligjor, që do të sjellë fiskalizimi. Kuantifikimi është i nevojshëm, ju e kërkuat dhe ne do t’jua sjellim.

Arben Ahmetaj – Qartë, mendova se e dëgjova gabim, se do të kuantifikoni përmirësimin administrativ për shkak të fiskalizimit.

Po, zoti Angjeli.

Anastas Angjeli - Faleminderit, zonja Ministre!

Diskutimi i projektbuxhetit dhe i paketës fiskale përbën pa dyshim ngjarjen më të rëndësishme të këtij sesi të Kuvendit dhe të jetës parlamentare. Nuk është as për traditë e as rastësi që diskutimi i projektbuxheti bëhet bashkë me paketën fiskale, është më tepër një rrjedhim logjik po të marrim parasysh se çfarë është buxheti, çfarë përfaqëson dhe cilat politika luajnë rol të rëndësishëm për të paraqitur një buxhet sa më realist dhe për ta zbatuar atë.

Në fund të fundit, kur diskutojmë buxhetin, siç filluam ta diskutojmë edhe sivjet, pa dyshim që mbajmë parasysh faktin se çfarë arrijmë me këtë buxhet. A arrijmë të plotësojmë funksionet e shtetit? A arrijmë të plotësojmë synimet e programit të qeverisë? A arrijmë të garantojmë një zhvillim të qëndrueshëm dhe një rritje ekonomike, që të plotësojë nevojat tona? A mund të realizojmë me këtë buxhet një program investimesh që ta garantojë këtë zhvillim? A i përmbushim ne disa objektiva sociale në fushën e shëndetësisë, të arsimit, të sigurimeve? A mundemi që me këtë buxhet të përballojmë ato reforma që kemi marrë përsipër?

Në finale, përveç shtetit, ekonomisë dhe çështjeve sociale, ne shohim edhe atë që e quajmë buxhet familjar të qytetarëve. Çfarë përfundon në përmirësimin e jetës së qytetarëve me këtë buxhet me këto politika, që do të zhvillojmë gjatë vitit të ardhshëm? Qytetari shqiptar do të jetojë më mirë se një vit më parë, do të plotësojë më shumë nevojat e konsumit, do të plotësojë më shumë nevoja jetësore të tij. Këto janë shumë të rëndësishme kur ne diskutojmë një projektbuxhet.

Në këtë funksion vjen edhe politika fiskale që dërgon qeveria për të treguar mbështetjen që i jep buxhetit të shtetit për vitin pasardhës. Prandaj, politika fiskale buxhetore, politika e shpenzimeve dhe politika monetare janë një trinom shumë i rëndësishëm për të realizuar një buxhet sa më realist dhe për ta përballuar situatën ekonomike dhe sociale të vendit në vitet e ardhshme.

Çfarë kuptohet nga paketa fiskale që ka sjellë qeveria për vitin 2019? Unë besoj se këtu kemi dy mesazhe, së pari qeveria ka një qasje për këtë vit, që të mos sjellë shumë politika të reja fiskale, por të vazhdojë konsolidimin e politikave fiskale që kemi ndërmarrë në vitin 2018. Një pjesë ligjore në 6-mujorin e dytë do të zbatohet këtë vit përmes atij që e ka quajtur “aksion miradministrimi fiskal” nga i cili do të marrë rezultate më të larta në administrimin dhe mbledhjen e të ardhurave. Pra, ka një ndryshim për këtë vit, nuk sjellim një paketë fiskale me politika të reja edhe pse kjo si paketë fiskale ka elementet e veta në secilin nga të katër projektligjet e politikave të përmirësimit të administrimit, por edhe të

ndryshimit të ndonjë politike falë përvojës që është krijuar nga zbatimi i tyre në vitet e kaluara.

Po t'i bashkosh projektligjet që ne kemi miratuar për t'u zbatuar dhe janë zbatuar gjatë vitit 2018, dhe disa ligje të tjera që ne i zbatuam pjesërisht në vitin e kaluar, atëherë krijohet një ide edhe më e plotë e një pakete fiskale, por që synim tani ka zbatimin dhe administrimin e saj.

Unë dua të kujtoj disa nga elementet e kësaj pakete, por më parë, siç e përmendi edhe zonja ministre, ju e dini që në këtë paketë vijnë 4 projektligje për t'u ndryshuar: ai i procedurës tatimore, ai për taksat kombëtare, për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe tatimi mbi të ardhurat. Këtyre po t'i shtojmë edhe ato elemente që ne morëm parasysh gjatë vitit të kaluar dhe që kanë të bëjnë me projektligjet që trajtojnë problemet e trajtimit financiar suplementar të punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë, në industrinë naftës apo ato për përfitimet suplementare, për të tria profesionet për përfitimet shitesë mbi pensionet e pleqërisë, për detyrimin ligjor të krijimit të skemës suplementare të pensioneve nëpërmjet kompanive private, ose disa kushte të tjera për daljen lehtësuese në pension për minatorët ose naftëtarët, ose disa çështje që kanë të bëjnë me masat që ne morëm për të nxitur dhe stimuluar biznesin, siç ishin ato që morëm në fushën e materialeve të ambalazheve, të artikujve të plastikës, për rimbursimin e taksës jo vetëm për ambalazhet, por edhe përjashtimi nga pagimi i taksës për një sërë lëndësh të para të këtyre artikujve plastikë, po t'i bashkojmë këto, së bashku me faktin që ne përpiqemi të kemi një regjistër tregtar për të rritur transparencën nga pikëpamja e administrimit të të gjitha veprimeve fiskale, mund të themi që jemi në një variant të një vazhdimësie të paketës fiskale me fokus administrimin. Këtë duhet të jemi të ndërgjegjshëm ta themi.

Ministrja përmendi edhe elementet e përmirësimit të administrimit në secilin ligj dhe elementet që mund të jenë dhe të konsiderohen si elemente të reja të ligjit, qoftë në ligjin e tatimit të vlerës së shtuar, qoftë tek ajo e taksave kombëtare, qoftë tek të ardhurat, qoftë te përmirësimi i administrimit fiskal. Unë besoj se të gjitha këto janë elemente të rëndësishme në drejtim të objektivit që i kanë vënë qëllim vetes qeveria dhe ministria dhe të qasjes që ajo do të sjellë midis politikave të reja fiskale dhe fokusit në përmirësim dhe administrim fiskal. Po ta shikojmë në këtë këndvështrim duket se qasja i shërben qëllimit. Pa dyshim që këtu ka disa elemente që duhen konsideruar, besoj unë dhe që ne do të kemi fatin t'i diskutojmë edhe në kuadër të përgjigjes së pyetjeve, por veçanërisht kur të diskutojmë për projektet veç e veç. Për shembull, të katër projektligjet, dy prej të cilëve më shumë dhe dy më pak, i referohen ligjit të fiskalitetit, të monitorimit dhe administrimit, të cilin ne sot nuk e kemi. Nga

pikëpamja e teknikës legislative dhe juridike nuk ka sens, sepse nuk vihet këtu dhe t'i referoheni një ligji që nuk është. Pra, ne duhet ta kërkojmë dhe ta kemi atë ligj, qoftë nga pikëpamja e elementeve të hyrjes në fuqi, por qoftë edhe nga pikëpamja e reflektimit të nocioneve që janë në atë ligj, sepse një pjesë e tyre mund të ndryshojnë atje dhe duhet t'i ndryshojmë edhe ne këtu. Kështu, që nga kjo pikëpamje, ju lutem, konsiderojeni këtë çështje që mundësisht sot ai të kalojë, sepse duhet të vijë këtu të shqyrtohet më përpara se ligjet e tjera, që ne t'i referohemi atij ose së paku të bëhet pjesë e paketës sa kohë që si katalog është si udhërrëfyes për ligjet e tjera.

Së dyti, pavarësisht se paketa fokusohet në qasjet e administrimit, ju jeni përpjekur që të bëni edhe një përllogaritje të efekteve financiare që vijnë nga dy ndryshimet thelbësore dhe nga një i pritshëm që është një ligj ose vendim qeverie, që do të dalë për rivlerësimin e banesave, si edhe një shtesë që keni konsideruar ju për efekt të ndryshimeve, që mund të bëhen në ligjin e akcizave, të cilat vijnë duke u rritur pafundësisht.

Unë besoj se me qasjen e re që keni ju duhet të na sillni edhe programin në zbatim të administrimit që do të bëni dhe efektet që do të sjellë ajo, sepse ju këtë qasje e filluat sivjet me aksionin e fiskalitetit, për të cilin ju keni një rezultat për aq sa keni bërë. Duke u nisur nga kjo që doni të bëni, duhet të na thoni që këto 4 ligjet që sollët pasi t'i harmonizoni me ligjin që do të vijë, do të keni këtë program, i cili do të na çojë në këtë rezultat. Ne duhet të dimë një gjë, edhe pse bëmë një qasje ndryshe këtë radhë për efektet e që dihen, për çdo qasje të re ose do të rrisësh taksat, ose do të zgjerosh bazën, ose do të bësh një miradministrim. Atëherë këto do të kompensojnë njëri-tjetrin. Prandaj, do t'ju lutesha shumë gjatë kohës së diskutimit të mund të na sillni një program që ju e keni në zbatim të këtyre projektligjeve. Pikërisht këto dy elemente do të na krijojnë një ide më të qartë.

Së treti, mua më shqetëson fakti se mbase duhet të reflektojmë ndaj raportit të "Doing Biznes". Ka pasur shumë mendime pas daljes së atij raporti që Shqipëria i çpozicionua me 20 pikë. Unë besoj se gjithnjë në këtë klasifikim ka dy elemente teknike që janë të rëndësishme: ndonjëherë ndonjë shtet bie, sepse nuk ka bërë politikat e duhura, por ndonjëherë bie edhe se ngrihen shtetet e tjera për shkak të politikave të mirave që kanë bërë ata dhe ne pse ne kemi ndenjur në vend ose nuk kemi lëvizur. Është shumë e vështirë të përcaktosh ndikimin e këtyre faktorëve që të thuash unë nuk kam rënë 19, por kam rënë 9, sepse 10 kanë ngritur të tjerët, por kur treguesi është i përmasave të tilla që është 19 pikë unë besoj se ka vend që ne ta përmendim këtë çështje qoftë ju në politikat tuaja, qoftë edhe në masat dhe programin që ju duhet të bëni për të reflektuar. E thashë këtë, sepse flasim për

paketë fiskale, sepse ligji i paketës fiskale është kryesori që ndikon në klimën e biznesit dhe ne jemi në një fazë që duhet patjetër ta shikojmë edhe këtë çështje.

Së fundi, për vitin në vazhdim ka ardhur koha që të kemi një fokus perspektiv të paketave fiskale në dy drejtime, pikë së pari, çfarë po ndodh sot me ligjet fiskale dhe si i përgjigjet ndryshimeve të sotme të ekonomisë në vendet e tjera sidomos në ato europiane dhe të zhvilluara. Ne nuk duhet të presim t'i bëjmë kur të hyjmë në Europë, sepse harmonizimi i legjislacionit shqiptar me atë europian është kusht. Sot flitet për elemente të reja taksash që kanë të bëjnë me ambientin, me teknologjinë, dhe derisa të gjithë po fokusohen te problemet që kanë të bëjnë me zhvillimet teknologjike dhe klimetarike, ne duhet të shikojmë për aq sa na takon në vendin tonë edhe këto çështje që kanë të bëjnë me politikat e reja fiskale. Këtu e kam fjalën për vitin në vazhdim që ne duhet të fokusohemi në këtë çështje.

Së fundi, do të thosha se ndonjëherë politikat fiskale i paraprijnë edhe mendimit të politikave ekonomike, pra ku jemi sot dhe ku duhet të shkojmë nesër, a do të shkojmë ne në disa politika të reja? Ne kemi folur shumë për prioritetet e zhvillimit ekonomik, kemi përcaktuar prioritet klasike: bujqësinë, energjinë, transportin, turizmin. U bënë 30 vjet që këtë histori themi, ndajmë edhe buxhetin për to. Por, a do të vazhdojmë me këtë histori apo ka ardhur momenti që ne të fokusohemi dhe të mos heqim dorë nga këto? Ne jetojmë në një ambient ekonomik natyral dhe ekonomik që i ka këto elemente, e ka edhe bujqësinë, e ka edhe nevojën e transportit, e ka edhe turizmin, jemi bërë edhe pjesë e tregjeve rajonale në këto fusha. Por ka ardhur koha që në funksion të atij objektivit, që kemi edhe në buxhet, që themi se një nga objektivat është të rrisim punësimin dhe zhvillimin. Ne duhet të fokusohemi në disa elemente të reja të zhvillimit ekonomik, industrive, artizanateve, në bashkëpunim me turizmin dhe të ecim më para që ne të bëjmë zgjedhjen tonë ku po shkojmë pas 30 vjetëve. Këtu politika fiskale dhe instrumentet fiskale janë shumë të rëndësishme dhe mund t'u paraprijnë disa gjërave të tjera.

Në këtë kuadër unë duke mbështetur këtë paketë besoj se e kam mirëkuptimin për çështjet që përmenda. Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Besoj se jeni dakord të bëjmë 10 minuta pushim që të mbledhim pyetjet. Si procedurë secili mund të bëjë nga një pyetje, dhe pastaj ato që kemi ia dorëzojmë Ministrisë së Financave dhe Ministria e Financave do të na vijë nesër me të gjitha përgjigjet.

Besoj jeni dakord.

10 minuta pushim!

Arben Ahmetaj – Deputetët nga pozita do të bëjnë pyetje. Përgjigjet do t'i jepni nesër, që të keni mundësi të përgatiteni. Maksimumi brenda një orë e gjysmë do t'ju vijë me shkrim të gjitha pyetjet që mendojmë ne, që të mos ngarkohemi sot. Besoj që të njëjtën gjë do të bëjë edhe opozita, do të bëjnë pyetje këtu dhe më pas do t'i dërgojnë me shkrim në sekretari. Sekretaria do t'ju dërgojë me shkrim. Nesër do të zhvillojmë seancën e pyetjeve.

Jeni dakord?

Anila Denaj – Kam një koment për një vlerësim të përgjithshëm të komenteve tuaja. Është e nevojshme ta shpreh, apo të pres të gjitha pyetjet?

Arben Ahmetaj – Unë mendoj se nesër mund të mbani qëndrim për çdo gjë.

Anila Denaj – Dakord.

Arben Ahmetaj – Pra, sugjerimi im është që nesër të keni një qëndrim për buxhetin dhe t'u referoheni pyetjeve një nga një. Aty ku pyetjet përsërisin njëra-tjetrën, ose përgjigjen ju e jepni me qëndrimin tuaj, nuk është nevoja ta prekni dy herë. Dakord?

Nëse keni merak sot që të mbani qëndrim, është e drejta juaj.

Anila Denaj – E para, ju falënderoj edhe për dy elementet e rëndësishme, si në raport me projektbuxhetin, ashtu edhe me paketën fiskale.

Në raport me projektbuxhetin, më lejoni të theksoj se po, *dateline*-i vjen i munguar. Nuk vjen i munguar në qasjen tonë, por i munguar në shkrim. Më duhet të theksoj edhe një herë sot, pavarësisht nga detajimi i fjalës, që *dateline*-i i këtij buxheti konsiston në tri elemente kryesore:

Së pari, konsolidim fiskal.

Së dyti, mbështetje e sektorëve kryesorë të ekonomisë, kryesisht bujqësisë dhe turizmit brenda një pakete të zhvillimeve ekonomike drejt energjisë së pastër.

Së treti, mbështetje e përmirësimit të cilësisë së jetesës, kryesisht me rritjen e investimeve në arsim dhe në shëndetësi.

Megjithatë, sikurse e thatë edhe ju, zoti kryetar, ne mund të biem dakord. Gjatë rrugës do të ngelet *dateline*-i, pasi në fund ka një qëndrim të përbashkët, i cili duhet të jetë koherent.

Në raport me paketën fiskale, është e saktë. Ju kërkojmë ndjesë për dorëzimin me vonesë të ligjit të fiskalizimit, i cili po aprovohet sot. Gjithsesi, ky ligj është diskutuar shumë herë me palët e interesit. Më duhet të theksoj disa nga ndryshimet që sollën edhe vonesën, e cila vjen si rezultat i qasjes në këtë projektligj edhe të aplikimit të ndryshimeve që kanë ardhur nga grupet e interesit të konsoliduara.

Megjithatë, politika fiskale këtë vit synon atë që thatë ju, zoti Angjeli, që ne të kalojmë në politika më afatmesme, të cilat do të ndihmojnë edhe në konsolidimin fiskal, edhe në lidhjen që thamë pak më parë, të *dateline*-it të buxhetit.

Zhvillimi ekonomik në sektorë kyçë, i parë drejt ekonomisë së gjelbër dhe i mbështetur me teknologji, duhet të vijë i bashkërenduar me politika ekonomike dhe jo vetëm fiskale. Sigurisht, këto politika fiskale të jenë në terma afatmesme 3-vjeçare, që të krijojnë mundësinë e parashikueshmërisë edhe nga biznesi, që ata të adoptojnë projeksionet e tyre, por edhe administrata të rregullojë të gjithë pjesën procedurale, për të qenë koherente dhe jo me problematika, siç shpesh mund të ketë ndodhur në momente të caktuara, për të cilat ne jemi duke punuar edhe me një ekip të FMN-së, për të parë dhe simplifikuar këtë proces në vijueshmëri.

Besoj se në kontekstin e të gjitha shifrave të dhëna këtë vit, përtej diskutimit që do të bëjmë, ne do të argumentojmë rritjen ekonomike që kemi propozuar, e cila, si në raport me pritshmërinë e vitin 2019, edhe në vitin 2020, do të mbështetet në tregues konkretë.

Së pari, në vitin 2019, në faktin që 6-mujori i dytë i vitit ka pasur gjithmonë peshën më të madhe në ritmin e rritjes ekonomike për dy arsye:

E para, sepse 3-mujori i tretë i këtij viti dhe i çdo viti ndikohet relativisht edhe nga kushtet e përmirësuar të efektit që ka energjia. Këtë pritshmëri e kemi edhe këtë vit, ashtu sikurse edhe efekti i turizmit, i cili, sigurisht, krijon një impakt më të lartë në 3-mujorin e tretë sesa në 3-mujorin e dytë apo të parë. Në mënyrë absolute kjo nuk na heq përgjegjshmërinë që ne ta kemi më të detajuar dhe t'jua sjellim atë në vijim.

E fundit, në raport me investimet publike, në mendojmë që nuk kanë ardhur në ulje, si në raport me vlerën absolute, ashtu edhe në përqindje. Më lejoni ta konkretizoj këtë element. Shpenzimet kapitale në vitin 2018 janë 78,4 miliardë; në pritshmin 2019 78,4 miliardë lekë; në pritshmin e vitit 2019 janë 80,7 miliardë lekë dhe në të pritshmin e vitit 2020 janë 83,7 miliardë lekë.

Gjithashtu, buxheti i vitit 2020 programon një përqindje 4,7% ndaj produktit të brendshëm bruto, i cili është i njëjtë me të pritshmin e vitit 2019 dhe qëndron më lartë me mesatare në 5 vjetët e fundit me 4,5%.

Detyrimet e prapambetura:

Zoti kryetar, më lejoni t'ju falënderoj për qasjen ndaj detyrimeve të prapambetura, pasi mendojmë se është e njëjta qasje edhe e Ministrisë së Financave në raport me detyrimin që kemi për të shlyer detyrimet e prapambetura dhe hapjen e tyre si zëra të parë të buxhetit për çdo njësi shpenzuese, duke filluar jo vetëm nga institucioni i Autoritetit Rrugor, por edhe

pushteti vendor, i cili ndikon më pak në këtë zë me një shumë rreth 6,7 miliardë lekë, ndërkohë që ne flasim. Qasja e Ministrisë së Financave, sikurse e treguam në fillim të këtij viti, edhe ndaj ARSH-së ishte çelja e buxhetit me detyrimin për të paguar 2,5 miliardë lekë për detyrime të prapambetura. Gjithsesi, një nga argumentet e dhëna nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ishte procesi i auditit, i cili, për të konsoliduar dhe për të konfirmuar disa nga proceset e brendshme për të shlyer këto detyrime konform këtij audit, vonoi këtë proces. Megjithatë, ministria do të jetë këtu dhe do ta referojë një gjë të tillë.

Mendoj se procesi i detyrimeve të prapambetura është një proces që buxheti dhe drejtoria e buxhetit e ka shumë të qartë orientimin që dhatë ju, për të shlyer detyrimet e prapambetura. Ka nevojë jo vetëm për të sjellë mungesë vonese, por, njëkohësisht, edhe për të orientuar një transparencë më të lartë.

E fundit, në raport me politikën sociale, është e vërtetë që në pamje të parë buxheti nuk sjell qasje të politikave të reja sociale, por

Arben Ahmetaj – Pyeta për politika të reja, jo ...

Anila Denaj – Po, për politika të reja.

Më lejoni të theksoj që këtë vit nuk kanë munguar politikat sociale. Konsolidimi në një vit më pas nuk është i pamundur për të parë dhe për të reflektuar të gjitha masat e marra këtë vit, si ndaj sektorëve të caktuar që përmenda pak më lartë, por edhe ndaj disave që janë ende të paadresuar. Projektaktet janë duke u përgatitur dhe do t'u adresohen individëve me aftësi të kufizuara. Efektet për ndryshimet e një viti mund të konsolidojnë më shumë sesa një vit. Unë do të doja që ju të gjithë, si deputetë, ta kishit këtë gjë në konsideratë, pasi është e nevojshme të mos i nënvlerësojmë efektet e këtij viti për atë pasardhës.

Elementet e caktuara, që kanë të bëjnë me terma të treguesve makro-ekonomik fiskal ne do t'i kemi jo vetëm të sqaruara në përgjigjet tona, por edhe të argumentuara nesër do të jemi të hapur të shikojmë nëse do të biem dakord të dyja palët.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Ministre!

Do të fillojmë me pyetjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sot do të bëjmë pyetje, të mos ngatërrohemi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ministrja do të jetë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të zhvillojmë vetëm pyetje.

Urdhëroni!

Artur Roshi – Faleminderit, zonja Ministre!

Së pari, dua të vlerësoj sinqeritetin tuaj, që projektbuxheti i këtij viti nuk sjell asgjë të re! Nëse do t'i japësh një temë diplome një studenti për të krahasuar projektbuxhetet e viteve të fundit, kryesisht të vitit 2019 dhe të vitit që parashikojmë, do ta ketë vështirë të shikojë ndasitë thelbësore, për të mos thënë që janë *copy-paste*, por me redaktime dhe korrektive të vogla, të papërfillshme.

Bie në sy se projektbuxheti i vitit 2020 nuk ka investime të reja në infrastrukturë, por thjesht kemi një vazhdimësi të projekteve të rrugëve që janë në proces, edhe këto jo të gjitha. Pra, kemi një hap pas të qeverisë apo ndjenjën e frikës për të vërtetën, që është turrja e investimeve. Është një projektbuxhet nën moton “Ilogaritë nuk të dalin ndonjëherë, ndaj lëre në gjendje të lirë dhe mbyll sytë të fundosesh”. Është projektbuxhet ankthi, për mendimin tim, për pasigurinë e të ardhurave që do të gjenerojë ekonomia shqiptare; është projektbuxhet i paradepresionit ekonomik, që reflekton uljen e shpenzimeve të konsumit, mungesën e dukshme të investimeve në tërësi. Nuk ka të ardhura nga punësimi. Themi se 2 milionë lekë të ardhura në vit i ndajnë të punësuar në një vend pune apo në dy vende pune. Pra, njerëzve që punojnë më shumë se një punë doni t'i vendosni një taksë të re. Kjo është një taksë e re për njerëzit që duan të punojnë ose të mbijetojnë me ndershmëri në treg. Kjo prek më shumë qarqet e niveleve të mesme, intelektuale, të njerëzve që kërkojnë të jetojnë me djersën e ballit dhe unë them se duhet parë. Keni kohë për ta parë.

Së treti, te taksa e luksit thoni se amortizimi brenda një viti i një makine që ble duhet të jetë 10%. Kryesisht, rregulli numër 1 i kontabilitetit: amortizimi dihet që është 20%. Edhe vetë koncesionarët, kur ti ble makinën, nëse do ta rikthesh makinën, për çdo vit të mbajtur të zbresin 20% amortizim, që do të thotë se vlera e makinës vjen duke bërë një zbritje progresive të vlerës së saj.

Arben Ahmetaj - Cila ishte pyetja?

Artur Roshi – Janë komente dhe pyetje.

Arben Ahmetaj – Ju lutem, përmbajuni ...

Artur Roshi – Ju lutem, mos më ndërprisni!

Janë disa logjika... Nuk ka dashakeqësi këtu, që ...

Arben Ahmetaj – Nuk është çështje dashakeqësie. Dua t'i përmbaheni axhendës.

Artur Roshi – Unë po jam opinione, të cilat ajo mund t'i ndërrojë. Këto janë 3-4 gjëra të kapura kështu.

Për sa u përket pyetjeve, kam 50 të tilla dhe do t'i bëj në sekretari.

Arben Ahmetaj – Bëjini me shkrim, ju lutem!

Artur Roshi – Patjetër.

Këtu janë 3-4 gjëra që preken. Ju do të thoni se taksa e luksit është 5%. Do të thotë se ne dalim kundër rregullit, jo 20%, por 10%. Kush na detyron ne të dalim jashtë rregullave fundamentale që janë për amortizimin, për kontabilitetin në ekonomi? Unë them se kjo duhet tërhequr.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çdo makineri teknologjike ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të bëjmë shpenzime vetëm një herë?

Të mos bëjmë debat. Më lejoni të mbaroj.

Arben Ahmetaj – Ju lutem, mos bëni debat me anëtarët e komisionit!

Artur Roshi – Më ngacmuan ata, jo unë.

Arben Ahmetaj – Nuk ju ngacmoi njeri, sepse ligjin për 20%-in e ka bërë po ky parlament, edhe 10% është për arsye fiskale, që atyre që quhen “të pasurit e nivelit më të lartë”, t’u amortizohet vlera fiskale më ngadalë, që të taksohen më shumë.

Artur Roshi – Ju keni logjikën tuaj, ne kemi logjikën tonë.

Shumicën e votave e keni ju, por unë do të them mendimin ku cenohen.

Për ju, armiku është luksi, ai që fiton para.

Sigurisht, ju keni krijuar një klasë biznesi që nuk konkurren ndershem në treg, por kjo është çështje tjetër. Le ta lëmë këtë.

Keni një taksë tjetër shtesë për regjistrimin e makinave në momentin e parë, që vlen për çdo qytetar. Besoj se edhe kjo taksë shtesë duhet tërhequr.

Në relacionin e projektbuxhetit thuhet se ka një rritje ekonomike që do të jetë 4,1% në vitin 2020. Sa ndikon kjo rritje ekonomike drejtpërdrejtë te buxhetet familjare, pra te xhepat e qytetarëve, pra në të ardhurat për frymë në dollarë apo në lekë për vitin 2020? Në çfarë mënyre e konceptoni ju se ndikon në joshjen e mendjengriturve për të ikur nga vendi, në mënyrë që ata të mos largohen për shkaqe ekonomike? Sa mund të jetë numri i shqiptarëve që ju prisni t’u neutralizoni tundimin për t’u larguar nga vendi për shkaqe ekonomike? A ka kuptim kjo taksa inovative që ju po fusni te fiskalizimi, rikonceptimi që i bëni në përputhje me rritjen e teknologjisë, avancimin e saj? Unë mendoj që kjo sjell një kosto të shtuar për biznesin dhe i bie të mos ketë kuptim që privati t’i paguajë para qeverisë që qeveria ta kontrollojë atë.

Pra, nëse ju do të vendosni programe me teknologjinë e re duhet që këto t'i blejë dhe t'ia vërë në dispozicion qeveria privatit, por prapë kjo gjë nuk ka sens. Deri më sot të gjitha kasat i ka paguar privati. Ju nuk mund të justifikoheni me faktin se kështu e ka bërë çdo qeveri më parë dhe kështu do ta bëjmë edhe ne. Për çdo gjë që na duhen shpenzimet e qeverisë, qeveria është në treg. A keni dëgjuar ju që në Shtetet e Bashkuar atë Amerikës, zoti Tramp e mbylli qeverinë, sepse nuk funksiononte për iks arsye objekti një sektor i caktuar?

Pra, qeveritë apo bashkitë e ndryshme atje kreditojnë nga qeveria federale, janë në treg. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës bashkitë mund të falimentojnë, ndërsa ne këtu kemi në treg vetëm privatit, por edhe ai nuk e ka tregun e lirë, kemi edhe qeverinë që sundon mbi të, mbi tregun e lirë, duke e diktuar atë me ligje dhe rregulla ashtu sikundër kemi rastin e fundit, atë të Unazës së Re. Thuhet se te Unaza e Re do të respektohet ligji, por çfarë ligji respektohet atje? Çfarë do të thotë koncepti “qeveri”, zonja ministre, sipas jush? Sipas meje është një shpikje e mendjes njerëzore për t'u ardhur në ndihmë qytetarëve...

Arben Ahmetaj – Zoti Roshi...

Artur Roshi – Nuk është qeveria padroni i qytetarëve, që e voton atë për t'i shërbyer, prandaj është koncepti i shërbimit.

Arben Ahmetaj – Zoti Roshi, cilat janë pyetjet tuaja.

Artur Roshi – Pyetje kam pa fund.

Arben Ahmetaj – Siç ramë dakord të dy palët pyetjet do t'ia dërgojmë me shkrim ministres.

Artur Roshi – Po patjetër.

Arben Ahmetaj – Do t'ia dërgoni sekretarisë, sepse do t'i konsolidojmë si pyetje në mënyrë që të mos i venë pyetje nga të gjitha anët.

Dakord?

A ka pyetje të tjera?

Artur Roshi – Kisha një pyetje...

Arben Ahmetaj – Ke pyetje interesante?

Artur Roshi – Po, kisha një pyetje interesante.

Arben Ahmetaj – Bëjeni me shkrim që të ngelet në historikun e parlamentit shqiptar.

Artur Roshi – Nuk është e nevojshme, duhet të mbetet e regjistruar me zë.

Me këtë teknologjinë ose taksën që ju rrisni për shkak të saj, i bie që një punëtor ndërtimi duhet të bjerë me këmbë në tokë. Një punëtor ndërtimi nuk mund të pajtojë një ekonomist...

Arben Ahmetaj – Për kë taksë e keni fjalën?

Artur Roshi – Për taksën nëse punon më shumë se në një vend pune, pra për tatimin që merr në fund të vitit nëse kalon mbi 20 milionë lekë të vjetër.

A ka mundësi çdo individ të pajtojë një ekonomist? Nuk është bërë barrë fiskale për të? Kjo është klima e biznesit që themi në tërësi, kjo është për individin. Ju nuk lini individin të mbijetojë, lëre më biznesin, i cili ka marrë fund.

Arben Ahmetaj – Dua t'ju bëj një sqarim. Këtë nuk e ka vënë as maxhoranca dhe as ministrja, është e hershme dhe e mirë në këndvështrimin tonë, megjithatë...

Artur Roshi – Unë vlerësoj avokatinë tuaj, zoti kryetar, dhe të qeverisë, pasi mikrofonin e keni në mënyrë permanente. Unë them mendimin tim dhe kaq.

Arben Ahmetaj – E drejtë.

Artur Roshi – Ju thoni mendimin tuaj, ata që na dëgjojnë ne janë qytetarët, pra këtu nuk ka kuptim.

Votën e keni, fjala është ajo që ne themi në Kuvend dhe për këtë e kemi marrë mandatin, nuk e kemi marrë mandatin që të tjerët të na anatemojnë. Respekti këtu është fjala, unë them mendimin që qytetarët të shohin variantin tjetër të mendimit njerëzor, i cili është varianti i filozofisë konservatore moderne europiane. Varianti juaj, varianti i Marksit, e kanë provuar 50 vjet të shkuara, sepse kapitalizmi qëndron mbi rregullat e tregut të lirë nuk qëndron mbi rregullat e socializmit.

Arben Ahmetaj – Në respektin tuaj pyetjet tuaja do të depozitohen...

(Diskutime pa mikrofon)

Në mënyrë absolute...

(Diskutime pa mikrofon)

Do të merresha me ato që thatë ju, sepse thatë gjëra të rëndësishme, por më pas sa bie dakord apo jo, kjo është diçka tjetër.

Sa i përket avokatisë, nuk kam nevojë të bëj avokati të punës së qeverisë, sepse shifrat flasin vetë dhe janë shumë pozitive. Rritja ekonomike po, konsolidimi fiskal po, rritja e konsumit po, rritja e të ardhurave për frymë po, rritja e investime të huaja, po. Avokatia ka dy mënyra, një avokati boshe dhe një avokati plote. Avokatia plote bazohet në statistika që qeveria i ka të konsoliduara ndër vite, duke përfshirë edhe këtë vit, kjo ishte edhe arsyeja që debati i diskutimit, të paktën qëndrimi im është çka të përmirësojmë në favor...

Po, ne jemi të majtë, ne do të vazhdojmë të mbështesim të gjitha shtresat në nevojë, patjetër. Qeveria reflekton gjithë qëndrimin e maxhorancës dhe të Kryeministrit. Jemi të majtë, e majta dhe e djathta kanë ndryshuar ndër vite. Për dijeni tuaj ne jemi e majta

europiane, që në fakt është kundër atyre që ju bëni sikur jeni kundër, është kundër oligarkëve...

(Diskutime pa mikrofon)

Jo ndaj jush si Artur, jo...

Artur Roshi – Unë kam profilin tim politik dhe për këtë u mundova edhe kur e mora mandatin, për të krijuar profilin tim.

Arben Ahmetaj – Të lutem, mos më ndërhyini!

Artur Roshi – Nuk kam lidhje me ato që ju...

Arben Ahmetaj – Unë iu referova të djathtës, jo juve, prandaj mos e merrni...

Artur Roshi – Ti iu referove qendrës së djathtë...

Arben Ahmetaj – Të lutem, Artur, nuk t'u referova ty, por të djathtës që ju përfaqësoni. Do t'i referohem së djathtës si mbështetëse e një përqindjeje shumë të vogël të popullsisë gati 2-3% dhe këtë e tregon taksa 9%. Taksa 9%, mund të kërkonte shifra nga Ministria e Financave, do të thotë që e gjithë ngarkesa fiskale t'i zbrësë pjesës më të pasur të Shqipërisë dhe t'i kalojë pjesës më në nevojë të shqiptarëve.

Pra, që në këtë sekondë çfarë është e majta europiane dhe e djathta europiane, çfarë është e majta shqiptare dhe e djathta shqiptare...

(Diskutime pa mikrofon)

Nuk të jap leje, ndryshe e mbyll mbledhjen.

Pra, duke thënë këtë, diskutimi dhe pyetjet janë dy gjëra të ndryshme. Avokatia është një gjë e domosdoshme. Avokatia jonë, fatmirësisht, bazohet në shifra shumë pozitive, të paktën për 6 vjetët e fundit që drejton qeveria socialiste. Mendoni ju se është e lehtë të menaxhohet...

(Diskutime pa mikrofon)

Të lutem, nuk keni më leje.

Artur Roshi – Jam *non grata* për komisionin?

Arben Ahmetaj – Pyetje të tjera më pas fjalën do ta ketë dikush tjetër.

...situata në çdo qelizë të financave publike? Po pse nuk e ndiejnë ministren në vështirësitë e përditshme që ka? Dinamika është përditshme, prandaj pyetjet dhe qëndrimet tona janë...

Artur Roshi – Zoti Ahmetaj, një fjali të vetme kam.

Arben Ahmetaj – Ta mbaroj unë fjalën pastaj merreni ju.

...në funksion të përmirësimit edhe të llogarive të buxhetit, edhe të transparencës së buxhetit...

Artur Roshi – Sipas jush.

Arben Ahmetaj - ... edhe të politikave që ne kemi.

Zonja Dhima, pyetjet tuaja, ju lutem!

Artur Roshi – Zoti Ahmetaj, edhe filozofët progresistë merren me pasojat dhe jo me shkakun, konservatorët merren me shkakun dhe ky është dallimi themelor ndërmjet të majtës dhe të djathtës.

Arben Ahmetaj – Të lutem, nuk do të bëjmë debat filozofik këtu. Ndonjë ditë më fto për drekë dhe mund ta bëjmë debatin, por jo këtu se nuk ka vlerë.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Ministre dhe stafit të ministrisë suaj për prezantimin e buxhetit për vitin 2020!

Unë kam disa pyetje, por nga të gjitha pyetjet po ju bëj vetëm dy dhe të tjerat do t'ju dërgojmë me shkrim.

E para, të ardhurat nga tatimet, doganat dhe kontributet krahasuar me vitin 2018 ulen, pothuajse përgjysmohen.

Në buxhetin fillestar të vitit 2019 parashikohej se të ardhurat nga tatimet, nga doganat dhe nga kontributet do të rriteshin me 22,7 miliardë lekë, krahasuar me vitin 2018, ndërkohë që realizimi i pritshëm i të ardhurave është 11,5 miliardë lekë. Pyetja ime është: cilat janë argumentet që këto të ardhura janë përgjysmuar?

Së dyti, në relacionin e buxhetit të vitit 2019, me ndryshimet që u bënë me ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, u vlerësua se do të sillnin një efekt negativ me minus 0,3 miliardë lekë. Cilat janë arsyet që të ardhurat nga TVSH-ja prej 13,1 miliardë lekësh janë më pak se plani i parashikuar deri në këtë moment që ne po diskutojmë buxhetin e vitit 2020?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Zonja Kushi, ju lutem, mund të bëni vetëm një pyetje, sepse pyetjet e tjera do t'ia dërgojmë me shkrim ministres, në mënyrë që t'i japim kohë të përgjigjet nesër.

Evis Kushi – Unë kam një pyetje, që mendoj se duhet të jetë e para, pa filluar me pyetjet teknike. A është konsultuar paketa fiskale me grupet e interesit, me biznesin dhe me dhomat e tregtisë? Në fakt, kjo është një pyetje teorike, sepse me siguri që duhet të jetë konsultuar, por ajo ku unë dua të dal është: cilat janë shqetësimet kryesore, që kanë ngritur ata? Cilat probleme e shqetësojnë më shumë biznesin sot? A janë reflektuar këto shqetësime

në këtë paketë fiskale, apo jo? Sa ka qenë e mundur që këto probleme të pasqyrohen në paketën fiskale?

Pyetjen e dytë e kam të fokusuar më shumë te buxheti i pushtetit vendor. Para pak ditësh në medie është bërë një debat për keqadministrimin e financave apo buxheteve nga një pjesë e konsiderueshme e bashkive të vendit. Në këtë debat flitej për detyrime të prapambetura të disa bashkive, qoftë për sa u përket pagesave të energjisë elektrike, qoftë edhe për sa u përket pagesave për proceset gjyqësore, madje edhe për pagesat e sigurimeve shoqërore të punonjësve. Si do të zgjidhet kjo çështje? Çfarë masash ka marrë ministria juaj në këtë drejtim? A reflektohet kjo në buxhetin e pushtetit vendor, apo jo?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – A ka pyetje të tjera për ministren?

Po, ju lutem, vetëm një pyetje!

Suzana Topi – Faleminderit, zonja Ministre!

Atëherë, në projektbuxhetin e vitit 2020 është parashikuar një rritje ekonomike me 4,1%. Sipas Bankës Botërore, kjo rritje ekonomike nuk parashikohet. Cilat janë politikat buxhetore ekonomike dhe politikat fiskale? A ka politika të reja në këtë rritje ekonomike që ju keni parashikuar?

Pyetjet e drejta po ju drejtohem me shkrim.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Po, zonja Gjylameti.

Blerina Gjylameti – Faleminderit, zonja ministre!

Faleminderit, kryetar!

Atëherë, duke marrë shkas nga parashikimi i të ardhurave, si dhe duke parë që të gjitha zërat e të ardhurave janë në rritje për sa i përket vitit 2020, do të doja të dija: sa realiste është ky parashikim, duke pasur parasysh faktin që edhe përgjatë vitit 2019 kemi rishikim të të ardhurave? Po ashtu, edhe në vitet e tjera kemi parë që shpeshherë ne bëjmë planifikime, të cilat jo gjithmonë dalin në linjë me atë çfarë realizohet. Këtë e bazoj duke parë të ardhurat e vitit 2019, ku vëmë re se ka një ndryshim nga plani i pritshëm me gati me 20,5 miliardë lekë. Pra, pyetja e parë ishte: sa realiste është ky parashikim?

Pyetja e dytë: sa do të ishte mosrealizimi pa të ardhurat shtesë, të cilat janë nga dividendi apo janë mbledhur nga dividendi?

Së treti, nëse hiqet efekti i dividendit, niveli i pritshëm i të ardhurave për vitin 2019 rezulton rreth 25,4 miliardë më pak se plani fillestar. Duke e krahasuar edhe me vitet e mëparshme, cilit vit mund t'i referohemi ne? Përsëri i qëndroj asaj që thashë në fillim: sa

realiste është planifikimi për të ardhurat e vitit 2020, duke marrë parasysh historikun se që nga planifikimi të realizimi jo gjithmonë jemi në linjë dhe shpeshherë do të duhet t'i rishikojmë planet?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Po, ju lutem.

Zoti Vullnet më pas e keni ju fjalën.

Krenar Ryçi - Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Ministre, për prezencën tuaj këtu, si dhe për prezantimin e projektbuxhetit për vitin 2020!

Në fakt, duke parë edhe shifrat në lidhje me këtë projektbuxhet, mendoj se nuk ka ndonjë ndryshim të madh nga vitet paraardhëse, pasi edhe koha nuk ishte e mjaftueshme për të na i referuar të gjitha. Unë do të bëj vetëm dy pyetje, sepse pyetjet e tjera i kam depozituar me shkrim në sekretari.

Së pari, pensionistëve u është premtuar një bonus, të cilën duhet ta marrin në prag të Krishtlindjes. A jeni konsultuar me grupet e interesit nëse do ta marrin pensionistët këtë bonos, apo jo?

Së dyti, kam një pyetje në lidhje me taksat e biznesit të vogël që, sipas ligjit, janë parashikuar rreth 8 milionë lekë të përfshira në TVSH. Gjithashtu, këto biznese kanë marrë shumë gjoba, për të cilat, pavarësisht se janë të detyruar t'i paguajnë, nuk kanë mundësi financiare t'i paguajnë, pasi gjendja e tyre ekonomike është shumë e dobët për arsye se të ardhurat e tyre janë shumë të vogla. A nuk do të ishte më mirë që ju të bëni një paketë fiskale për uljen e këtyre detyrimeve? Unë besoj se kjo do të ndikojë shumë te biznesi, nëse nuk është ndonjë shumë e madhe. Pra, t'i jepet pak mbështetje biznesit të vogël, sepse është e rëndësishme për vendin tonë. Pavarësisht se ne kemi një ekonomi të brishtë, a mund t'u bëjmë një falje fiskale këtyre bizneseve në prag të mbylljes së këtij viti, në mënyrë që t'u japim disa impulse të reja që ata të punojnë më mirë në të ardhmen?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Po, zoti Vullnet.

Më pas fjalën e kanë zoti Xhavit, zonja Lala, zonja Senida dhe më pas Eljo Hyskaj.

Vullnet Sinaj - Faleminderit, kryetar!

Në paketën fiskale të miratuar vitin e kaluar ka pasur një taksë të TVSH-së të reduktuar për fermerët me një vlerë 6% për grumbullimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale. Nga ana tjetër, agrobiznesi për produktet e gatshme që realizon do ta paguante TVSH-në 20%. Kjo skemë 6% e TVSH-së për grumbullimin e produkteve bujqësore dhe

blegtorale dhe 20% për agrobiznesin ka një diferencë me 14%. Unë mendoj se kjo nuk duket si një skemë TVSH-je, por si një skemë e detyrueshme. A ka dhënë kjo skemë efekte pozitive në ekonominë e vendit vitin e kaluar? Si mendoni ju, zonja Ministre, mos ndoshta ka ardhur momenti që ta ndryshojmë këtë skemë në këtë paketë fiskale, duke e barazuar TVSH-në e blerjes me TVSH-në e shitjes, pra 10% me 10%?

Në fjalën tuaj ju thatë se vitin e kaluar ka pasur një tkurrje të eksporteve dhe parashikoni që këtë vit ato të rriten me 5%. Pyetja ime është: cilat produkte të ekonomisë sonë, që eksportohen, do të pësojnë rritje?

Në këtë projektbuxhet ne nuk pamë asnjë rritje të pagës minimale. Pse nuk është parashikuar rritja e pagës minimale? Ne jemi vërtet në një situatë që, për hir të së vërtetës, ka largime masive të shqiptarëve nga Shqipëria. Pse nuk është parashikuar në këtë buxhet rritja e pagës minimale në këtë buxhet?

E fundit, zonja Ministre, është renta minerare. Meqenëse në paketën fiskale kemi ligjin për taksat kombëtare, a parashikohet të rritet pjesa e rentës minerare që rri në pushtetin vendor, pasi sot në ligj është vetëm 5%? Duke menduar që burimet minerare, nafta dhe minierat nuk janë afër detit apo qyteteve, por në zonat rurale, atje ngelet vetëm 5% të rentës minerare, unë mendoj që duhet rritur renta minerare që rri në pushtetin vendor, dhe shpresoj që edhe ju të më mbështesni. Po të isha unë vet, do ta bëja barazim 50 me 50, pra, ata që kanë burimin, me qeverinë që i merr.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Do të bëj një sqarim, nëse ma lejon, zoti Vullnet. Nëntoka është pasuri kombëtare, jo lokale.

Faleminderit!

Po, zoti Xhevit.

Xhevit Bushaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Zonja Ministre, ju falënderoj për ekspozitën e këtij projektbuxheti!

Seanca që po diskutojmë sot është një ngjarje shumë e rëndësishme, ndaj ka një angazhim dhe përkushtim maksimal të të gjithë deputetëve për këtë projektligj.

Kam dy pyetje: Kur mendoni të dilni në tregun e eurobondit dhe në çfarë faze përgatitore jeni, nëse e keni filluar?

E dyta, çfarë keni pasur parasysh në ndarjen e transfertës së pakushtëzuar për 61 bashkitë apo 12 qarqet, kur keni paraqitur një pasqyrë në këtë projektbuxhet?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Xhevit!

Po, zonja Lala.

Reme Lala – Faleminderit!

Dua të bëj një pyetje lidhur me atë që përcjell ndryshe projektbuxheti apo paketa fiskale: Cila është risia e politikës fiskale dhe buxhetit për vitin 2020? Ku do të jetë orientimi i qeverisë në investimet publike, në ndihmë të cilës shtresë të popullatës: tek të rinjtë, te studentët apo te shtresat në nevojë? Cili është fokusi në shërbimet publike të ofruara?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Po, zoti Elio.

Zonja Mesi, ju jeni në fund për arsye shumë specifike.

Elio Hyskaj – Përshëndetje!

Zonja Ministre, kam dy pyetje: e para, sa është parashikuar rritja e transfertës së pakushtëzuar të qeverisë për bashkitë? A është parashikuar ajo në bazë të gjendjes financiare të bashkive, numrin e popullsisë, nevojave dhe një historiku të investimeve? Pra, në rastin kur një bashki është në një nivel të lartë borxhesh, a kemi parashikuar ne t'i shkojmë në ndihmë?

E dyta, kur themi se do të rriten investimet për arsimin, sportin, kulturën dhe çështjet sociale, a janë bazuar ato mbi një pasqyrë të nevojave sipas bashkive? Pra, a ka një ndarje të drejtë në bazë të nevojave dhe të historikut të investimeve? Ne vazhdojmë të investojmë për të gjashtin viti radhazi në të njëjtën bashki, për të njëjtin komunitet, apo po bëjmë një rishpërndarje në bazë të nevojave dhe në bazë të këtij historiku?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Zonja Mesi, urdhëroni!

Senida Mesi – Përshëndetje!

E nderuara zonja Ministre,

I nderuar kryetar i komisionit,

Të nderuar kolegë,

Ne kemi adresuar një set pyetjesh pranë stafit të komisionit, të cilat do t'ju vijnë me shkrim, por, meqë preferuam që një apo dy pyetje t'i diskutojmë në prezencën tuaj, pyetja ime është në lidhje me planin e administrimit fiskal, të cilin e përmendi edhe profesor Angjeli. Duke vënë re që të ardhurat e pritshme të vitit 2019 rezultojnë pak a shumë rreth 11,5 miliardë lekë më shumë se të ardhurat e vitit 2018, ndërkohë që 11,1 miliardë lekë më shumë të ardhura vijnë nga politika fiskale, ku është efekti i administrimit në rastin konkret dhe rritja apo shtesa natyrale që duhet të vinte nga kuadri ekonomik, kjo e vlefshme për vitin 2019, por sigurisht shumë e vlefshme për vitin 2020, meqenëse edhe në lajtmotivin e paraqitjes së paketës fiskale ishte pikërisht konsolidimi fiskal nëpërmjet miradministrimit?

Pyetja tjetër, që më shkon për shtat ndoshta, por që dua të di edhe më shumë informacion, ka të bëjë me pjesën e investimeve publike. Si është bërë shpërndarja e investimeve publike për qarqet në Shqipëri? Sa për qind e investimeve publike ka marrë secili qark dhe e përkthyer kjo në detaje, sa janë investimet publike për frymë në bazë qarku?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Zonja Ministre, që të mos marr kohën e deputetëve, pyetjet e mia do të jenë pjesë e atyre që do t’ju sjellë sekretaria.

Nëse doni të mbani ndonjë qëndrim tani, jeni e mirëpritur, por, nëse doni të përgjigjeni nesër, jemi dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo do të mbaj qëndrim.

Ministrja ka të drejtë të flasë sa herë që vendos të ndërhyjë.

Anila Denaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Qëndrimi im do të përqendrohet vetëm në tri pika.

Së pari, në raport me të gjithë kontekstin jo të saktë të sjellë edhe në vëmendje të publikut për sa i përket taksës inovatore të fiskalizimit, zoti Roshi, unë ju ftoj që me leximin e ligjit të fiskalizimit të kuptoni se kjo nuk është taksë e re, nuk është kosto e shtuar e biznesit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më lejoni ta mbaroj!

Sigurisht, ne do të kemi mjaftueshëm kohë për ta diskutuar pse kjo është...

Arben Ahmetaj – Zonjat e komisionit, mbani qetësi, sepse po flet ministrja!

Anila Denaj – Në këtë paketë fiskale ose paketë ndryshimesh në legjislacionin fiskal është shumë e rëndësishme të konsiderohet realiteti shqiptar në raport me fokusin e miradministrimit, i cili në tregues, sikurse na u kërkua edhe nga ju zoti kryetar, që ne të japim referencat e të gjithë përpjekjes sonë për luftën kundër informalitetit, se cilat janë gjetjet dhe ku do të orientohemi në të ardhmen ndaj informalitetit. Ky është një realitet shqiptar, i cili vetëm nga ky vit i përpjekjeve për të luftuar informalitetin, në të gjitha inspektimet e kryera nga Drejtoritë e Përgjithshme të Tatimeve, Doganave dhe institucionet e tjera, masa 40% e gjetjeve duhet të na shqetësojë të gjithëve. Masa 40% e gjetjeve në shkelje të ligjit është e lartë dhe nuk mundet të mbështetet vetëm nëpërmjet gjetjes me inspektime, sepse ndikon në klimën e biznesit, por duhet të mbështetet në të dhëna në kohë reale, më të sakta dhe më të miradministruara, që do të shoqërohen me një ndryshim të strukturës së administratës, për të

qenë më moderne dhe më bashkëkohore. Në këtë frymë dua ta shikojmë ligjin e fiskalizimit përtej kostove.

Kam një pyetje për ju: Nëse mendoni se kostot do t'i paguajë qeveria...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju po propozoni që kasën fiskale ...

Arben Ahmetaj – Zoti Roshi, në respekt të ministres, ju lutem, dëgjojeni në përgjigje!

Anila Denaj – Ju po propozoni që kasën fiskale si shpenzim të biznesit apo kujtdo produkti që do të mbështesë edhe aplikacionin, i cili është i vetmi element i shtuar, ta paguajë shteti. Unë do të preferoja të bëja rritje të rrogave dhe mbështetje të shtresave sociale, më mirë se të paguaj një kosto që i takon biznesit.

Megjithatë, besoj se do të kemi mjaftueshëm kohë që ta trajtojmë, por ju lutem, mos keqinformoni për taksa të tjera shtesë!

Në frymë të luftës kundër informalitetit bëhen edhe përpjekje të tjera për të ekuilibruar evidencat e informalitetit që kemi parë në raport me individët që kanë më shumë se një të ardhur të deklaruar brenda sistemit “DIVA”, i cili është *friendly user*. Nëse ai që ka aplikuar për ta plotësuar ka pasur probleme, besoj se administrata ka qenë aty për ta ndihmuar.

Ky është sqarimi për sa i takon informalitetit dhe është një nga qëndrimet e para që dua të theksoj për të gjithë pyetjet që u vendosën në këtë tryezë.

E dyta, në raport me të ardhurat tatimore dhe doganore në fund të këtij viti, e kuptoj shqetësimin e një rishikimi të sjellë në raport me të ardhurat në krahasim me projeksionin, i cili në të dyja elementet, si pozitiv, edhe negativ, ka elemente të caktuara, ku taksa e dividendit ka përformuar përtej parashikimeve. Më lejoni të them se vetëm këtë vit ulja e dividendit nga 15 në 8% gjeneroi 11 miliardë lekë në 10-mujor, nga 3,6 miliardë që ishin arkëtuar vitin e kaluar. Pra, ka sjellë një rritje prej 7,6 miliardë lekësh. Kjo nuk është e vetmja taksë, e cila ka sjellë përmirësime në të ardhurat totale, por edhe shumë taksa të tjera, sikurse ka edhe diferenca të konsiderueshme në disa elemente të taksimit dhe mbi të gjitha në efektin që kjo sjell në buxhetin e shtetit, ku më kryesorja dhe më e rëndësishmja është TVSH-ja.

TVSH-ja në disa elemente ka efekt negativ, që lidhet me efektin e rritjes ekonomike deri në këtë periudhë të rishikuar, me lehtësimet që u janë bërë imputeve bujqësore me gati 1,2 miliardë lekë, me kursin e këmbimit, që ka pasur një ndikim, sepse përlllogaritja ka qenë e ndryshme, me 2,1 miliardë lekë. Ne do t'jua sjellim të gjitha me detaje, si ato që kanë ndikuar

pozitivisht, edhe ato që kanë ndikuar negativisht, sikurse edhe elementi që mund të lidhet me pamundësinë totale për një rritje të miradministrit që vjen si rezultat i informalitetit.

Ne nuk pretendojmë që një sistem faturimi do të zgjidhë informalitetin vitin e ardhshëm. Ne kemi parashikuar që kjo do të vijë brenda 2-3 vjetëve të ardhshëm, jo vetëm për arsye të projektit, i cili ka një zgjatje 2-vjeçare, por edhe të efekteve të tij, që do të jenë afatmesme, me një efekt të 9,1% të produktit të brendshëm bruto brenda vitit 2021, nga 8,8% që është aktualisht.

Lidhur me të gjitha shqetësimet në raport me pushtetin vendor dhe transfertën e kushtëzuar, më lejoni të them që një reformë reale e ndodhur në qeverisjen socialiste në 5-vjetët e fundit i ka deleguar i kompetenca pushtetit vendor, e cila duhet të shoqërohet me një rritje përgjegjshmërie, minimumi për të mos rritur detyrimet e prapambetura. Në vijim të asaj që thamë në diskutimin e buxhetit, kjo është prioritare për të gjithë pushtetin vendor para se të mendojmë projekte të reja. Pushteti vendor ka kompetenca, të cilat janë të rritura nga një vit në tjetrin në raport me të ardhurat që gjeneron. Kjo është evidencë edhe e aktit normativ të ndryshuar të këtij viti. Mund të bëhen politika për të zgjeruar impaktet në investime dhe në efekte sociale, por jo në krijimin e detyrimeve të prapambetura në vijim. Këtë qasje, siç e thashë edhe në fillim të diskutimit, si në pushtetin qendror, edhe në atë lokal, ne si Ministri e Financave duam ta adresojmë duke çelur buxhetin me elementin bazë si do të shlyhen detyrimet e prapambetura qoftë edhe për pushtetin vendor.

Pjesa tjetër e shqetësimeve në raport me detyrimet e prapambetura të ISSH-së, edhe në vëmendje të publikut, më lejoni të them se këto detyrime janë duke u analizuar, masat janë duke u parë për t'u marrë, sepse nuk janë krijuar sot, por datojnë që në vitin 2000.

Arben Ahmetaj – Moza, po flet ministrja, mos fol edhe ti!

Anila Denaj – Një trajektore, e cila ka luhatjet e saj rritëse dhe ulëse, nuk i heq përgjegjësinë asnjë qeverie në gjithë këto vite për të adresuar korrekt, sidomos ndaj biznesit, i cili shpesh në detyrimet e tij ka lënë pagesat e sigurimeve shoqërore, para se të vendosë shlyerjen e detyrimeve të tjera. Këto masa janë duke u ndjekur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në raport me institucionet buxhetore që janë bërë referencë edhe në daljet publike. Më lejoni të them se ky është një proces i zgjidhur aktualisht në rregulloren e brendshme të Drejtorisë së Thesarit dhe me pretendimin që këto nuk do të akumulohen në të ardhmen ne do të zgjidhim çështjen e detyrimeve të prapambetura në mënyrë korrekte brenda vitit që vjen.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Atëherë, biem dakord që brenda 1 orë e gjysmë do t'i dërgohen pyetjet Ministrisë së Financave.

Do t'i lutem deputetëve të opozitës që pyetjet t'i dorëzojnë me shkrim ose me *e-mail* te sekretaria, që ministria të marrë një listë të konsoliduar dhe nesër të kalojmë te përgjigjet.

Mbledhja mbyllet.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti